



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.01.2020, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar" (*Komision përgjegjës*)
2. Projektligji "Për ratifikimin e Konventës së Minamatës "Për mërkurin"" (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Robert Bitri, Andrea Marto, Ilir Ndraxhi, Egllantina Gjermani, Ardit Konomi, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Nimet Musaj.Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Edmond Leka dhe Zef Shtjefni.

Mungojnë:

Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja dhe Tatiana Nurçe.

Të ftuar:

Artan Shkreli- Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Agron Hysenlliu- Drejtor i Institutit të Ndërtimit

Egra Ibrahim- Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elona Bushpepa- Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Alba Punavija- Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Albiona Korita- Specialiste në Ministrinë e i Infrastrukturës dhe Energjisë

Ornela Çuci- Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marikaj- Përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Lindita Tafaj-Përfaqësuese e ISHP-së

Nexhila Kodra-Përfaqësuese e MSHMS-së

Miranda Daja- Përfaqësuese e MSHMS-së

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi - Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Kjo është mbledhja e parë për këtë sesion, prandaj ju uroj të gjithëve punë e vit të mbarë!

Në këtë mbledhje kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar”.

Ky projektligj ka ardhur në Kuvend në datën 28 tetor. Pra, dua t’ju vë në dijeni që ka ardhur pas tërmetit të shtatorit. Data shqyrtimit në seancë është parashikuar 30 janari. Relatorë është zonja Gjermani.

Do të fillojmë me një prezantim të ligjit nga relatorja, zonja Gjermani dhe më pas me përfaqësuesit e ministrisë, të cilët janë: Artan Shkreli, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Agron Hysenlliu, Drejtor i Institutit të Ndërtimit, Egra Ibrahim, përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Elona Bushpepa, specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Alba Punavija, specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Albiona Korita, Specialiste në Ministrinë e i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar.

Ju uroj suksese të gjithëve!

Para se të fillojmë, unë desha t’ju them se ju e keni ndjekur fjalën time kur ra tërmeti dhe u vonuam pak në lidhje me zhvillimin e seancës plenare po sot nuk dua të them këtë, por t’i propozoj këtij komisioni që ne të ngremë një komision për të parë se çfarë ka ndodhur në atë që quhet “gropa e kuçedrës”, pra të shkojmë ta shohim dhe verifikojmë në vend, sepse ka gojëdhëna dhe njerëz që thonë se aty janë bërë ndërhyrje nga segmente të caktuara edhe të shtetit dhe atyre që kanë qenë përpara kësaj qeverisje. Kjo është një kërkesë imja paraprake.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Do ta diskutojmë me komisionin. Nuk besoj se komisioni ynë e ka këtë tagër, por gjithsesi do ta diskutojmë. Do të flasim edhe me shërbimet e komisionit për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse e keni për procedurë, dakord, por, nëse jo, lini relatoren të flasë.

Andrea Marto - Duke qenë se unë jam i fushës për çështjen e tërmeteve, them se shkencërisht shqetësimi që paraqiti kolegu nuk qëndron. Prandaj, është e mira dhe në nderin e komisionit të mos e vazhdojmë këtë diskutim. Nuk ka nevojë.

Kujtim Gjuzi – Unë kam të drejtën e replikës. Kolegu i nderuar ka të gjithë tagrin e vet ta shprehë pjesën e vet speciale nëse ne do ta ringremë grupin për të parë gjendjen në vend. Unë këtu nuk kërkoj të jem specialisti, por si deputet i prefekturës Durrës-Krujë unë e kam këtë shqetësim dhe dua ta përcjell këtë shqetësim, pastaj komisioni ta rrëzojë me votë, nuk ka asnjë problem.

Niko Peleshi - Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermeni – Faleminderit!

Sot diskutojmë projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar”, që është nismë e Këshillit të Ministrave dhe konkretisht projektligji është iniciuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në kuadër të situatës së krijuar nga dëmtimet që shkaktoi tërmeti i datës 21 shtator të vitit 2019 në disa qytete të vendit për t’iu përgjigjur nevojës së menjëhershme për ndërtimin dhe riparimin e ndërtesave të dëmtuara. Ndryshimet e sjella nga ministria synojnë zëvendësimin e disa termave në ligj me synim harmonizimin me legjislacionin për planifikimin e territorit, shtimin e një neni, i cili vendos detyrimin për kryerjen e procesit të auditimit teknik në të gjitha objektet, të cilat janë ndërtuar para 50 vjetësh e më shumë sipas rregullave dhe mënyrës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, si edhe riformulimin e nenit që përcakton mënyrën e kryerjes së opionencës teknike, duke përcaktuar se ajo do të kryhet nga institucionet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit për të gjitha ndërtimet publike, jo publike me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë dhe objektet me akses publik, si: kinema, teatro, stadione e të tjera.

Unë mendoj se ky ishte një reagim i menjëhershëm nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë pas tërmetit të 21 shtatorit, por ajo që do të sugjeroja dhe të vija re është fakti që pas këtij tërmeti dhe, pasi kjo nismë është depozituar në parlament, ka ndodhur edhe një tërmet ende më i rëndë ai i nëntorit dhe, me sa kam parë dhe ndjekur, edhe Këshilli i Ministrave ka nxjerrë një vendim lidhur me sigurimin e ndërtesave dhe harmonizimin e disa terminologjive ose zhvillimeve në këtë fushë me ligjin e planifikimit të territorit.

A mund të kaloj në pyetje, zoti kryetar, për çështje që unë i konsideroj të rëndësishme?

Së pari, a mendoni se me këto ndryshime që ju keni sjellë në tetor, i mbulon apo i trajtoni të gjitha çështjet, të cilat lidhen me sigurinë e ndërtimeve edhe pas tërmetit të 26 nëntorit? Sepse këto ndryshime që ju keni sjellë kanë ardhur para këtij tërmeti dhe mendoj se problematikën që kemi hasur apo që keni hasur ju mund të jenë të ndryshme dhe të mos jenë të mbuluara të gjitha nga këto pak ndryshime që vijnë me këtë projektligj.

Së dyti, nuk di nëse ndryshimet që ju sillni në këtë projektligj janë të harmonizuara ose plotësojnë njëra-tjetrën me vendimin e Këshillit të Ministrave që ju keni sjellë, datën, në fakt, nuk e mbaj mend, por mendoj se është i datës 2 dhjetor për sigurimin e ndërtimeve dhe që është një nga vendimet e Këshillit të Ministrave për ligjin e planifikimit të territorit, nëse ky projektligj i sotëm harmonizohet dhe është i njësuar me ndryshimet që propozoni sot.

Ndërkohë, kur të diskutojmë nen për nen, kam edhe disa shqetësime të tjera specifike.

Niko Peleshi - Po, zoti Shkreli.

Artan Shkreli – Projektligji që shqyrtojmë sot ka dy aspekte kryesore, së pari, një rregullim terminologjik, i cili nuk është formal, por shpreh një përmbajtje të ndryshuar të disa prej institucioneve, të cilat janë parashikuar në nenet përkatëse, si edhe pjesa e dytë ka të bëjë me disiplinimin e punimeve të ndërtimit duke futur elementet e garancisë dhe certifikimit të objekteve, të cilat kanë një kohë të gjatë përdorimi dhe që në mungesë të pasaportave individuale të objekteve nuk dimë as përdoruesit, por as entet shtetërore gjendjen fizike dhe gjendjen e amortizimit të objekteve që kanë një kohë më të gjatë se 50 vjet, që janë ndërtuar.

Në këtë rast janë dy elemente, që kanë vënë në dyshim specifikat e këtyre objekteve. Së pari, koha e gjatë që ka kaluar dhe shumë nga materialet e ndërtimit, që shumë janë konsideruar të përjetshëm, si betoni, por praktika ka treguar se nuk është i përjetshëm, pra degradon me kalimin e kohës dhe për këtë është e arsyeshme që të bëhen herë pas here teste të betonit në objekte të ndryshme dhe, së dyti, janë ndërhyrjet njerëzore në këto objekte, të cilat kanë kompromentuar elemente të qëndrueshmërisë fizike dhe statike të objekteve duke bërë që në kushte normale ato kanë qëndrueshmëri, të themi, të pranueshme, por në rastin e goditjeve nga tërmeti ose faktorëve të tjerë, këto objekte mund të cedojnë.

Sikurse e theksoi edhe zonja Gjermani, këto rregullime janë përgatitur menjëherë pas tërmetit të shtatorit të vitit 2019, por tërmeti tjetër bëri që të kolaudojmë disa nga elementet dhe të vijmë me këtë projektligj ku ndërmjet të tjerave është edhe vlerësimi i projektaktit, në raport me programin politik të Këshillit të Ministrave, me programin analitik të akteve, si edhe me dokumente të tjera me natyrë politike.

Duhet të theksojmë se ky projektligj nuk synon ndonjë përafrim me *acqui communautaire*, por nuk bie ndesh me rregullimet ligjore që janë ndërmarrë në ministrinë tonë në raport me miratimin e eurokodeve. Pra, të gjitha këto rregullime janë në përputhshmëri edhe me rregullimet që po ndodhin, si edhe argumentohen përparësitë në raport me efektet e pritshme.

Ky është thelbi i ndryshimeve që ne kemi sjellë.

Artan Shkreli – Mund t’i përgjigjem pyetjes?

Niko Peleshi – Edhe një herë në interes të pyetjes që kishte zonja Gjermani...

Artan Shkreli – Kisha edhe diçka, pyetjeve duhet t’u përgjigjem tani apo pasi të jenë bërë të gjitha?

Niko Peleshi – Jo vetëm pyetjes së zonjës Gjermani dhe më pas do të hapim pyetjet për anëtarët e tjerë të komisionit.

Artan Shkreli – Zonja Gjermani bëri 3 pyetje.

E para, a mbulohen të gjitha çështjet që janë akumuluar gjatë kohës me këto ndryshime ligjore. Dua t'ju them se nuk mbulohen të gjitha çështjet, por vetëm për gjërat më emergjente që kanë dalë. Ne ndodhemi në kushtet ku ka shumë akte dhe vendime të Këshillit të Ministrave, por edhe rregullime ligjore me rastin e tërmetit, të cilat kryesisht do të ndihmojnë për rindërtimin, të cilat vijnë nga ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe kërkojnë kohë të shpejtë implementimi dhe për këto arsye jemi të detyruar që ndryshimet e tjera ligjore t'i pasojmë dora-dorës, por këto janë më thelbësoret që duhen kaluar më shpejt, sepse prekin thelbin e çështjes.

Pyetja e dytë ishte, nëse ky projektligj, i cili është përgatitur në klimën e tërmetit të 21 shtatorit 2019, ka marrë në konsideratë elemente të rinj që mund të kenë dalë nga tërmeti i nëntorit 2019. Ka marrë, janë ratifikuar disa elemente dhe janë specifikuar gjëra, të cilat ishin lënë më subjektive gjatë përgatitjes së parë. Për shembull, ligji për kolaudimin dhe certifikimin e objekteve që kanë mbi 50 vjet është strukturuar më mirë. Kjo ka lidhje me pyetjen e tretë, nëse harmonizohet me VKM-të e dhjetorit për sigurimin e ndërtimeve. Kjo gjë u është kërkuar kompanive të shërbimeve, por edhe autentëve në përgjithësi, një objekt nuk mund të sigurohet dot nëse nuk ka një certifikim të tij. Problematikat më të mëdha, ligji i sigurimeve është për objektet, sepse ato sigurohen deri në 10 vjet dhe objektet e reja i kanë të gjitha dokumentet përkatëse, por kjo nuk ekskludon që autentët duan të sigurojnë edhe objektet e vjetra. Certifikimi i objekteve të vjetra duke shkuar deri në këtë masë natyrisht që ia hap tregut këto objekte, përveç elementeve të sigurisë që i kanë nxitur ligjvënësit të merren me këtë çështje.

Niko Peleshi – fillojmë me pyetjet.

Zoti Marto e ka kërkuar fjalën. Më pas fjalën e ka zoti Gjuzi.

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, pas zotit Marto fjalën e ka zoti Musai.

Andrea Marto – Kisha dy pyetje të thjeshta. E para, ka të bëjë me përcaktimin e afatit të ndërtimeve që do të auditohen. Ju thoni 50 vjet. Ku jeni mbështetur që keni caktuar këtë afat? Pse nuk thoni 40 apo 45 vjet, sepse mund të ketë ndërtesa 30-vjeçare, siç tha zotëria, që mund të kenë nevojë për ndërhyrje urgjente?

E dyta, për sa kohë mendoni se do ta realizoni auditimin e ndërtesave pas aprovimit të ligjit?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Musai dhe më pas zoti Gjuzi.

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje teknike për zëvendësministrin Shkreli. Mendohet se për një pjesë të problematikave që kanë ndodhur shkak ka qenë ndërhyrja që është bërë në katet e para, te

shumë banesa të reja të viteve të fundit, por edhe tek ato të 30 apo 50 vjetëve më parë, kanë qenë një ndër shkaqet që shumë pallate janë rrënuar. A ka ndonjë studim ose reflektim që pas këtyre ndërhyrjeve që janë bërë këto pallate të rikthehen në gjendjen e mëparshme? Çfarë masash do të merren nëse nesër një tërmet tjetër që mund të ndodhë në Durrës, në Lalz, por Fier dhe në çdo qytet tjetër, pasi të gjithë e dimë që këto ndërhyrje janë masive duke hapur lokale, dyqane, supermarkete në katet e para dhe këto pallate të mirëndërtuara të asaj kohe sot janë një rrezik imediat?

Faleminderit!

Kujtim Gjuzi – Zoti Shkreli pyetja ime është në lidhje me ndërtimet. Ju këtu keni riformuluar një nen, neni 4/1. Në vijim të pyetjes së kolegut, për kohën 50 vjet, ju këtu nuk i keni cilësuar ndërtimet mbitokësore dhe nëntokësore, ky është edhe rreziku. Nëse ju i keni dëgjuar me vëmendje se çfarë kemi thënë në parlament, çfarë kanë thënë specialistët, zëra të veçantë janë, por janë specialistë, a e keni përfshirë ju kontrollin e minierave në Manëz, Kamëz dhe Mëzez?

Këto janë tri vendet ku tërmeti ishte më i fortë, rreziku më i madh dhe njerëzit që humbën jetën ishin pikërisht në këtë aks.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Shtjefni, fjala për ju.

Zef Shtjefni – Zoti kryetar,

Nuk është se ne kemi pasur ndonjë ligj të keq sa i takon ndërtimit edhe gjatë këtyre viteve, por sa u takon objekteve 50-vjeçare dua t'ju them diçka. Në Itali ra një urë dhe shteti menjëherë u vu në lëvizje duke verifikuar të gjitha urat në vend. Dua të di a është futur këtu te ne verifikimi i urave?

Marr shkak nga ura e Tapizës, një rrugë të cilën e bëj shpesh, atje është vendosur një tabelë për kalim vetëm në një korsi, por kjo nuk zbatohet asnjë ditë, duke vazhduar kalimi i makinave me tonazh të lartë dhe vetëm kur të bjerë ndonjë ditë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Beqaj, fjala për ju.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Kryetar, pyetjen do të ishte më mirë ta bëj më vonë, pasi mund të jetë si një mënyrë bashkëbisedimi.

Niko Peleshi – Vazhdojmë me përgjigjet e pyetjeve që u bënë deri tani dhe më pas fjalën do ta ketë zoti Beqaj.

Zoti Shkreli, ju lutem, përgjigjuni pyetjeve që keni marrë deri tani!

Artan Shkreli – A ka pyetje të tjera?

Niko Peleshi – Mund të ketë më pas.

Artan Shkreli – Po filloj me pyetjen e zotit Marto për përcaktimin e afatit 50 vjet. Pyetja është logjike: pse jo 40, 60 apo një periudhë tjetër kohore? Në përgjithësi gjithmonë është marrë një kriter përcaktues, objektet pak a shumë, nëse do të bëjmë dy ndarje të mëdha në Shqipëri, janë me muraturë tulle dhe betonarme. Kryesisht objektet, të cilat kanë pasur probleme të rënda janë objektet me shumë apartamente dhe objektet, duke bërë një statistikë të përgjithshme kanë qenë kryesisht objektet që kanë pasur një kohë relativisht të gjatë nga koha kur janë bërë, nuk po flas për rastet kur projekti është shkelur apo për rastet kur është bërë dëmtim në strukturë si rezultat i hapjes për lokale apo kate shtesë, të cilat kanë bërë peshë suplementare në raport me peshën e llogaritjes, por jam duke folur për objektet me të cilat nuk është abuzuar gjatë ndërtimit dhe përdorimit.

Kjo është një kohë që në shumë praktika botërore konsiderohet e mjaftueshme për të parë nëse betoni në rastin e godinave me betonarme i ruan elementet e tij apo jo? Ekziston një term tashmë që konsiderohet si kanceri i betonit, i cili nuk është i njohur. Janë bërë studime shumë të thelluara dhe vetëm 2 vjetët e fundit, që nga rënia e urës së famshme të Gjenovës, menjëherë pas rënies së urës së Gjenovës, në të gjithë Gjermaninë, gjermanët, të cilët janë më fiskalë se italianët sa i takon çështjes së mirëmbajtjes, kanë bërë një kontroll të të gjitha urave duke vënë një limit kohor për objektet, duke u bazuar në dy gjëra, limitin kohor nga njëra dhe nga ana tjetër zbatimi i punimeve. Për shumicën e objekteve është konsideruar 50-vjeçari si një kohë në të cilën betoni fillon dhe jep efektet e veta negative, fillon ajo që quhet shpërbërja kimike e betonit dhe eurokodet kanë të njëjtën kohë. Ne menduam t'i qëndrojmë, edhe në lidhje me atë që tha zonja Gjermani, përputhshmërisë midis këtyre ligjore që po ndërmarrim me aktet e tjera ku ne mbështetemi. Kjo është çështja e 50-vjetëshit, i cili mund të kishte qenë edhe 55 apo 45, por ne menduam të bëjmë pikërisht 50-n, duke reflektuar edhe termat kohorë që janë përcaktuar në eurokod. Kjo është koha në të cilën konsiderohet që betoni fillon degradimin dhe degradimi i betonit nuk është vetëm betoni në vetvete, por menjëherë pas degradimit të betonit fillon edhe degradimi i hekurit, pasi është betoni ai që e mbron hekurin.

Fenomeni që vumë re në Durrës, për fat të keq, ishte që në të gjitha kolonat apo trarët e dëmtuar hekurit ishte goxha e ndryshkur, që do të thotë se cilësia e betoneve në klimën e Durrësit duhet të ishte i ndryshëm nga një beton që mbahet në një zonë që nuk ka lagështirën apo kripën, sikurse është Durrësi. Të gjitha këto do të reflektohen në kodet tona të ndërtimit, të cilat do të rregullohen me VKM në të ardhme, prandaj siç jua thashë kjo nuk i sjell të gjitha rregullimet.

Pyetja tjetër kishte të bënte me kohën se kur do të bëhej auditimi i objekteve dhe certifikimi i tyre. Këtë nuk mund t'ju them në këto momente, sepse do të ketë agjenda të veçanta, të cilat do të bëhen nëpër qarqe dhe bashki të veçanta në varësi të resurseve dhe kapaciteteve njerëzore që ata kanë, por edhe të kapaciteteve financiare, sepse auditimi nëpër objekte kërkon edhe financim të grupeve të ekspertëve dhe të inxhinierëve, si dhe pajisje. Kjo do të fillojë kryesisht nga objektet me karakter publik siç janë spitalet, shkollat, stadiumet, supermarkata dhe objektet private me akses publik që mund të jenë kinema, salla lojërash e të tjera. Ky proces ka filluar për efekt të tërmetit, por tani do të jetë programatik. Edhe kur të mbarojë emergjenca e tërmetit dhe të shkrihen strukturat e ngritura për efekt të gjendjes së jashtëzakonshme, do të rregullohen me vendime të Këshillit të Ministrave qoftë mënyra se si do të procedohet, por në një farë mënyrë do të strukturohet edhe çfarë do të thotë auditimi në vetvete, pra do të ketë një rregullore të veçantë të miratuar me VKM, ku do të përcaktohet se cilat pjesë të objektit dhe deri sa thellë do të shkohet me auditimin.

Ideja është që rezultatet e auditimit (kjo është pjesa e cila do të ketë edhe efekt ekonomik) do të jenë detyruese për objektet për t'i çuar në normë sizmike. Është njësoj sikurse bëhet azhurnimi me normat energjetike ose të elektrikut, e njëjta gjë do të jetë nga ana sizmike. Kuptohet, që objektet, të cilat do të dalin të papërdorshme nga auditimi, do të ndahen në objekte që ia vlen të rikonstruktohen. Për shembull, nëse ndërhyrja është mbi 70%, ia vlen të shemben dhe të ribëhen, ia vlen apo jo, nuk mund ta themi ende këtë gjë, sepse do të auditohen edhe objekte, të cilat nuk kanë pasoja nga tërmeti.

Për t'iu përgjigjur pyetjes së zotit Musaj, se si do të bëhet për kthimin në gjendjen e mëparshme, nuk mund ta themi në këtë moment. Kjo do të varet nga sasia dhe cilësia e raporteve të auditimit dhe ky do të jetë një debat shumë i rëndësishëm, për hir të së vërtetës, ku do të implikohen edhe zyrtarë dhe ekspertë të Ministrisë së Financave, por edhe ekspertë që merren me ndërtimin, sepse ideja është që do të merremi vetëm me elemente që kanë natyrë strukturore, pra që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë e objektit, sepse, natyrisht, një ndërtesë ka shumë elemente të tjera.

Për t'iu përgjigjur pyetjes së zotit Gjuzi, i cili me shumë të drejtë shtron çështjen nëse ky ligj prek edhe ndërtimet apo konstruksionet nëntokësore, ku hyjnë edhe minierat në rastin konkret, në zonat e goditura nga tërmeti: Manza, Kamza, Mëzesi, gjithë zona e pellgut qymyrguror i Tiranës, Krujës dhe Fushë-Krujës e të tjera, këto rregullohen nga një ligj i veçantë që ka qoftë kontrollin, qoftë kolaudimin e këtyre objekteve, nuk e prek ky ligj, njësoj si digat dhe dambat, që edhe ato, për sa i përket çështjes së kontrollit dhe nivelit të sigurisë që kanë, rregullohen me ligj të veçantë, pra edhe ato nuk preken.

Sa u takon urave, ato i prek ky ligj. Menjëherë pas katastrofës së Genovas, ministria jonë bëri një mbikëqyrje, që zgjati disa muaj ku u angazhuan inxhinierë të ndryshëm edhe nga pushteti vendor që u udhëhoq nga Instituti i Ndërtimit dhe ARRSH-ja. Të gjitha urat e Shqipërisë, sidomos ato me moshë të madhe, janë skanuar dhe janë nxjerrë problematikat dhe ARRSH-ja ka për detyrë që vit pas viti, 4 ose 5 nga urat me problematika, t'u bëjë rikonstrukcion të plotë ose t'i shembë për t'i rindërtuar.

Në qoftë se ka interes, një kopje të raportit mund t'ia dërgojmë zotit Gjuzi, me të gjitha urat që kanë dalë si problematike, përfshirë Urën e Tapizës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

I përzejva këto, ngaqë zoti Gjuzi i përmendi urat, por ju i specifikuat më tepër me Tapizën, e cila ka dalë një nga urat me problematika të rënda, duhet të rikonstruktohet dhe për momentin janë marrë masa që të kalohet vetëm në një sens. Çështja e kalimit me dy sense është njësoj si Ura e Vorës, ku deri sa nuk kishte një kontroll të mirë policor, i cili operonte me heqje licensash e të tjera, ishin vënë dy trarë që nuk duhet të kalonin kamionë, por vetëm makina, por në një bashkëpunim, i cili zgjati vetëm dy javë me policinë, njerëzit u disiplinuan. Këtë gjë e bëjnë makinat e firmave, të cilat natyrisht përdoren edhe për qëllime fitimi. Kështu që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e mora shënim dhe do të komunikoj me njerëzit e policisë për këtë punë, se kjo gjë nuk duhet të ndodhë, se, nëse ndodh katastrofa, pastaj është shumë e vështirë të gjesh përgjegjësinë këtu.

Ilir Beqaj – Sigurisht, përpjekjet për të reflektuar ndaj atyre që ndodhën janë shumë të mëdha, por idenë paraprake të zgjidhjes, e shoh pak të sforcuar. Në ç'kuptim? Ne amendojmë një ligj të vitit 1998, i cili është amenduar disa herë, por që kur është miratuar në atë vit, ka vendosur rregullat se çfarë do të bëhet me ndërtimet në atë vit dhe më pas. Kërkojmë të hyjmë këtu me çfarë ka ndodhur në vitet 1967, 1968 e më parë. Mund të jem kontrovers, për mua do të ishte më mirë me ligj të veçantë, sepse supozojmë që e miratuam ligjin dhe sipas përkufizimit që mund të jetë edhe pak më shtrëngues ky neni, fraksion 1, ne themi i nënshtrohet, po nëse jo?

U miratua ligji dhe lindi detyrimi që gjithçka që është ndërtuar në vitin 1999 apo më i vjetër, t'i nënshtrohet këtij procesi. Mbas dy vjetësh e kap '72; mbas 4 vjetësh e kap '74. Mënyra si është i shkruar ky ligj, pas 5 vjetësh do të jetë në fuqi, e lexon dikush dhe thotë: "Të gjitha objektet që janë ndërtuar para 50 vjetësh dhe në qoftë se ky diskutim do të bëhet në vitin

2024, i kap '73 ato, s'i kap më '69". Cila është ideja, do ta vazhdojmë këtë punë edhe 10, 15 vjet, apo jo? Kjo është pyetja.

Artan Shkreli - Meqë e bëmë si bashkëbisedim, unë do të bëj një analogji me ligjin italian, pasi dikur jam marrë me monumentet e kulturës dhe e njoh mirë atë. Italianët konsiderojnë që çdo objekt mbi 100 vjet është një objekt, i cili deri sa të certifikohet, konsiderohet objekt i mbrojtur. Pra, një objekt mbi 100-vjeçar nuk mund ta shembësh në qoftë se Enti Rregullator për Monumentet nuk thotë që ky objekt duhet ruajtur.

Ata i kanë skanuar të gjitha objektet e veta dhe çdo objekt që bën 100 vjet në Itali, shkon ekipi dhe e certifikon, është futur në procedurë. Kjo është historia. Pra, duhen krijuar struktura pranë pushtetit vendor, të cilat do të merren vetëm me këtë gjë. Ndaj thashë, që këto do të rregullohen më vonë me akte, me një rregullore të veçantë, e cila specifikon edhe çfarë do të thotë nga ana e vetë inspektim, certifikim apo auditim dhe deri ku do të futet ky auditim.

Ilir Beqaj – Kjo logjikë, sërish më bën të them se do një ligj më vete. Te ligji i '98 është e vështirë, sepse ne shtojmë nenin 4/1, pas nenit 4. Vetë neni 4 ka për objektiv: rezistencën dhe qëndrueshmërinë, sigurinë ndaj zjarrit, higjienën, shëndetin, mjedisin, mbrojtjen nga zhurmat, eficiencën e energjisë e të tjera, pra janë standarde të së ardhmes, ndërsa ky mund të zgjidhej shumë më mirë me një ligj të veçantë për të kaluarën.

Ndërkohë, nisur nga ajo që thatë, dhe ashtu është, vjen në kundërshtim me relacionin që thotë se ky projektligj nuk ka shpenzime financiare për buxhetin. A do t'i shtohet volumi i punës atyre që do ta bëjnë këtë gjë? Kush do ta paguajë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Relacioni thotë kështu, por, normalisht, përderisa do të punojnë disa njerëz, dhe sidomos...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I bashkive? Po ku është thënë, se këtu nuk thuhet "pushteti vendor"? Nuk mundet që me VKM t'i ndërhysh qeverisjes vendore. Ka një ligj për pushtetin vendor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pushteti vendor kryen dy funksione, funksionet e veta, funksionet e deleguara. Janë të ndara cilat janë të vetat e cilat janë të deleguara. Një VKM që do të dalë pas këtij ligji, nuk mundet t'i vendosë një detyrë të re pushtetit vendor, edhe po ta vendosë, duhet ta vendosi ligji, që ai pastaj ose kur të kërkojë transfertën e kushtëzuar nga Ministria e Financave ose dhe vetë një këshill bashkiak, kur të miratojë buxhetin e vitit të ardhshëm dhe të thotë se do të përdorë këto shtesë, nuk mund të bazohet vetëm te një VKM, por ai do të niset nga kompetencat e veta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po kush ia jep këtë kompetencë?

Artan Shkreli – Kontrolli i territorit nuk më lejon të shkoj te një objekt mbi 50-vjeçar. Mua më duhet të marr një indicio nga bashkitë përkatëse. Çdo bashki ka të drejtën mbi bazën e performancës së objekteve që ka, sepse ajo kontrollon territorin, të më thotë mua që jam një ent më i specializuar, të shkoj dhe të bëj kontrollin pikërisht në atë banesë dhe të nxjerr se cilat janë performancat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

50, 100, ai mund të kontrollojë edhe 30-vjeçarët. Ne e kemi bërë një kufizim që këto i ka me detyrim, por mund të ketë edhe të tjera. Ne kemi praktika si institucion që i kemi bërë me bashkitë që kemi kontrolluar edhe objekte shumë më të reja dhe i kemi nxjerrë jashtë përdorimit ose janë rikonstruktuar duke nxjerrë performancën e tyre.

Në këtë aspekt, ata bëjnë një kontroll që na i sjellin neve, dhe ne themi që këto godina janë për t'u rikonstruktuar ose janë për t'u demolu. Kështu nxjerrim edhe kostot përkatëse, sepse një objekt mund të demolohet për efekt të vjetërsisë së vetë, por mund të demolohet edhe për efekt të kostove të riparimit, që nuk mund të arrihet të riparohet me atë kosto, sepse ka një kosto minimale fiskale. Në këtë aspekt janë ata vendimmarrësit dhe vetëm ata përcaktojnë se çfarë do të bëhet në territor. Ne të tjerët jem komplet jashtë kësaj gjëje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë duhet ta detyrosh që ta bëjë, se nuk është e përcaktuar në ligj.

Ilir Beqaj – Ky formulim nuk e detyron. Nejse, nuk kemi arritur ende nen për nen, se me VKM, për mendimin tim nuk e detyron dot pushtetin vendor. Me ligj, po.

Artan Shkreli – Prandaj e kemi futur në ligj.

Ilir Beqaj – Ideja është ta zbatojë. Në qoftë se ai nuk e ka detyrim ligjor, nuk e zbaton dhe na rroftë ne që diskutojmë.

Artan Shkreli – Prandaj po futet në ligj. 50-vjeçarin po e fusim në ligj, sepse ai e ka kontrollin mbi territorin, ndaj duhet ta bëj. Unë nuk e marr këtë indice që të shkoj dhe të kontrolloj objektin në terren pa më thënë, sepse ai është i zoti i vendit.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zoti Bitri dhe më pas zoti Gjuzi.

Robert Bitri – Cilat quhen ndërtime jopublike dhe pse këtu është vlera 1 milion? Pse të mos jetë 800 mijë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pse aty nën 100 jo?

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Shkreli - Atëherë, objektet ndahen në dy grupe, me akses publik dhe me akses privat. Kryesisht këtu flitet për objekte me akses publik, që mund të jenë edhe pronë private. Për shembull, TEG-u është një sipërmarrje private, ku akses i është publik dhe i gjerë, që do të thotë se shkalla e mbrojtjes së njerëzve në objektet me akses të madh publik duhet të jetë më e lartë se në objektet e tjera. Te kodet teknike, për shembull në shkolla, qëndrueshmëria e objektit duhet të jetë më e lartë se për apartamentet, njëra e ka 200 kilogramë për metër/katror, ndërkohë që shkollat e kanë 260 plus një koeficient tjetër e të tjera. Këto objekte konsiderohen si objekte të rëndësishme të veçantë në njëfarë mase dhe jo vetëm për efekt të peshës. E njëjta gjë është bërë edhe këtu, ku ka një klasifikim të objekteve me akses publik dhe objekteve me akses jopublik. Për sa i përket çështjes së 100 milionëshit po ia kaloj fjalën Agronit, meqenëse Instituti i Ndërtimit kryen opionencat për këtë shifër të caktuar.

Agron Hysenlliu - Ligji që kemi sot nr. 1055, e ka të përcaktuar vlerën 100 milionë, e cila është taksative dhe ne mbi këtë vlerë duhet të punojmë. Ky ligj është hartuar në vitin 1998 dhe ne këtë po kërkojmë të përmirësojmë, pasi ka...

Robert Bitri – Ju i referoheni kësaj shifre?

Agron Hysenlliu - Ne nuk i referohemi kësaj shifre, sepse për objektet mbi 100 milionë është, por ne duhet të fusim edhe objektet që janë nën 100 milionë, sepse...

(Diskutime pa mikrofon)

Ligji i sotëm përcakton vlerën mbi 100 milionë, ndërkohë që ne kërkojmë të fusim një element nën 100 milionë, të cilat kanë akses të madh publik.

Niko Peleshi – Jo me këtë projektligj.

Agron Hysenlliu - Ne kërkojmë që ta fusim te ky projekt.

Niko Peleshi – Në këtë projektligj nuk thuhet kjo gjë.

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Shkreli – Kur të kalojmë në diskutimin nën për nën kjo, duhet të specifikohet, pasi nga pikëpamja e ligjërimit është shkruar gabim. Pra, nuk duhet të themi “as së paku”, sepse vlera mbi 100 milionë është e detyrueshme edhe sot. Ideja tani është për objektet që janë nën 100 milionë.

Agron Hysenlliu – Dua të sqaroj diçka: ne e kemi kërkuar këtë ligj që në vitin 2014 sidomos për objektet, siç janë kopshtet, çerdhet, shkollat apo ambientet me akses publik, siç janë stadiumet, sepse në konceptin tim si inxhinier nuk duhej të ishte vënë vlera, por duhej të ishte vënë numri i kateve që ka një objekt, pasi vlera...

Niko Peleshi – Ju përfaqësoni qeverinë dhe në njëfarë mënyre ky është projektligji i qeverisë, ndaj, ju lutem, mos bëni komente për projektligjin e qeverisë.

Agron Hysenlliu – Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Doni t’jua shpjegoj unë? Nëse vetë qeveria vjen këtu dhe e kundërshton projektin e saj, pastaj bëhet...

(Diskutime pa mikrofon)

Po, por jo ta komentoj këtu!

Fjala për zotin Marto dhe më pas për zotin Pëllumbi.

Andrea Marto – Ta mendojmë se e miratuam ligjin dhe aprovohet afati 5-vjeçar i vjetërsisë, bëhet edhe auditimi i objekteve dhe kontaktohen se në disa objekte private duhet të ndërhyhet. Atëherë, kush do ta paguajë koston e këtyre ndërhyrjeve?

Kjo duhet menduar që tani, sepse, po e miratuam ligjin, ne duhet të themi që në këtë ndërtesë duhet të ndërhyhet, duhet të restaurohet ose duhet të shembet, atëherë kush do ta marrë përsipër koston? Ne duhet ta mendojmë këtë gjë.

Artan Shkreli – Kjo nuk mund të jetë pjesë e këtij ligji, pasi këto janë parashikuar në ligje të tjera se çfarë ndodh me këto objekte, të cilat janë të pabanueshme dhe i nënshtrohen ligjit si për çdo objekt tjetër.

Niko Peleshi – Nuk është ky rasti, zoti Shkreli!

Artan Shkreli – Kjo është në mënyrë absolute.

Niko Peleshi – Zoti Marto nuk po flet për rastet kur objekti del i pabanueshëm ose me rrezik shembjeje, por po flet për rastet kur ka nevojë për ndërhyrje dhe nuk ka nevojë që të prishen.

Artan Shkreli – Prandaj unë mendoj se kjo duhet të ketë një rregullore të veçantë, e cila duhet hartuar, ndërkohë që është një akt tjetër nënligjor që do të kalojë. Pra, do të jetë një rregullore e veçantë për mënyrën se si bëhet auditimi dhe çfarë do të ndodhë me efektet e auditimit, sepse edhe pabanueshmëria, e një objekti ka disa shkallë, njëlloj siç patëm për tërmetet DS3, DS4, DS5, do të jenë edhe ato. Në rastet që do të shpallen si objekte të pabanueshme në mënyrë imediate do të vihet shiriti dhe nuk do të lejohet të banohet te këto objekte, njëlloj si tek objektet që janë duke rënë. Gjithashtu, ka edhe objekte të tjera, të cilave u lihet një kohë e caktuar për të ndërhyrë për përforcimin e strukturës dhe natyrisht ka edhe objekte të tjera që mund të kenë nevojë për rregullime të vogla. Unë nuk e di se çfarë mund të ndodhë me këto objekte, sepse ne po flasim për këto objekte që kërkojnë rregullime të mëdha dhe në rastet kur kërkohen rregullime të mëdha, pra ndërhyrje në konstruksion për qëndrueshmëri të këtyre objekteve, të cilat nuk garantohen nga tërmetet, mënyra se si do të ndërhyhet do të shikohet në raport edhe me pushtetin vendor, pra sa do të paguajë privati, sa

do të paguajë shteti dhe nëse janë familje në nevojë, natyrisht që shteti do të marrë përgjegjësitë e tij.

Niko Peleshi – Ku fiksohen këto, pra cili është kuadri ligjor?

Artan Shkreli – Natyrisht që do të jetë një dokument i veçantë.

Niko Peleshi – Pra, do të jetë një akt nënligjor me VKM?

Artan Shkreli – Patjetër, do të jetë me VKM.

Ne e thamë që në fillim se këto do të shoqërohen me një rregullore përkatëse.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Gjuzi, ju lutem, respektoni radhën!

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Zoti Kryetar, unë erdha pak me vonesë dhe ndoshta janë thënë disa gjëra, të cilat nuk i kam dëgjuar, por do të doja të dija një gjë. Unë po bëj një përgjithësim, por brenda janë disa pyetje. Si është situata sot lidhur me oponencat? Pra, për cilat objekte bëjmë oponenca dhe a shtojmë objekte të tjera në këtë ligj nga ajo që kemi sot këtu para?

Së dyti, institucionet shtetërore që do të bëjnë oponencat janë po ato që kemi sot, apo do të shtojmë të tjera? I bëra këto pyetje për të arritur në konkluzionin se këto shtesa që do të bëjmë, nëse do të kemi të tilla, por besoj me siguri duhet të kemi, sepse më shumë nga ç'janë sot do të bëjmë nesër, a i kemi kapacitetet në këto institucione shtetërore për t'iu përgjigjur këtij fluksi në rritje oponencash?

Artan Shkreli – Unë do t'u përgjigjem pjesërisht disa pyetjeve dhe për pjesën tjetër do të përgjigjet drejtori i Institutit.

Kapacitetet janë për të bërë gjëra të tilla. Sot kemi një ushtri me inxhinierë civilë dhe mjafton që njëri prej tyre të plotësojë disa kushte që ne kemi përcaktuar edhe për retrofitet që u bënë me rastin tërmetit. Natyrisht që koha për bërjen e certifikimit të këtyre objekteve nuk do të jetë një kohë e paarsyeshme. Ajo që unë dua të theksoj këtu është se ne në një mënyrë apo në një tjetër ne do të kemi një panoramë apo një radiografi se çfarë po ndodh me objektet e vjetra në Shqipëri. Vendet e Europës Perëndimore bëjnë dy lloj ndërhyrjesh në kohë: së pari, bëjnë ndërhyrje të zakonshme, ku çdo 2 vjet rregullojnë parvazet e dritareve, lyejnë pallatet, vendosin dritat e shkallëve, pra fusin në normativë gjërat e vogla që mund të kenë ndryshuar; së dyti bëjnë ndërhyrje të jashtëzakonshme, *manutenzione straordinaria*, siç quajnë italianët, të cilat i bëjnë një herë në 10 vjet, pra një herë në 10 vjet ata bëjnë ndërhyrje të thella, duke filluar që te niveli i tarracave apo punime në themelet e objekteve nëse ka cedime objekti e të tjera. Kjo ka bërë që atje objektet të mirëmbahen vazhdimisht, sepse është me detyrim që një

herë në 10 vjet duhet të bëhen ndërhyrje të thella, sigurisht nëse paraqitet nevoja, sepse objekti nuk ka afat, por çdo 2 vjet ata bëjnë ndërhyrje të vogla. Unë mendoj se pas këtij rregullimi ligjor, pra në momentin që do të bëhet certifikimi i këtyre objekteve (ne e kemi panoramën e përgjithshme të gjendjes në të cilën ndodhen ndërtesat që shfrytëzohen në Republikën e Shqipërisë), atëherë me siguri që do të kalojmë më parë një ligj për mirëmbajtjen e banesave. Kjo më pas do të lidhet me sigurimin, por edhe me shumë gjëra të tjera.

Agron Hysenlliu - Faleminderit!

Situata sot është që për të gjitha objektet kryhet oponencë teknike, por mbi vlerën 100 milionë, siç e thamë edhe më parë, kurse për atë se sa mund të shtohen, mund të them që sado të shtohen kapacitet ato do të kryhen, pasi çdo inxhinier i licencuar me kategorinë 3B mund të kryejë oponencë teknike dhe të japë oponencë sesi mund të jetë një objekt. Oponenca teknike në vetvete ka të bëjë vetëm nëse janë zbatuar kushtet teknike, pra vetëm me projektin dhe nuk ka të bëjë me terrenin.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Gjuzi e ka fjalën.

Më pas zoti Konomi dhe më pas relatorja zonja Gjermani.

Kujtim Gjuzi – Siç e vëmë re në dy –tri raste administrata e përfaqësuar nga zoti Shkreli ka një lloj cedimi, pra ka një lloj paqartësie edhe te projektligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lejoni të mbaroj, sepse unë kam konsideratë për ju dhe besoj se e dini këtë gjë, por këtu jemi në një vend që kemi përgjegjësi, sepse, në fund të fundit, të gjithë marrim para ne këtu, që do të thotë se duhet të japim maksimumin e mundshëm në të gjithë këtë projektligj, të cilin do ta kalojmë atje. Pra, nëse unë do të votoj pro për këtë projektligj, duhet të jem i sigurt, ndaj po i rikthehem edhe një herë pyetjes: a e keni të sigurt se ligji është i plotë, sepse mua më duket se ligji është i paplotë? Prandaj, mendoj se duhet ta rishikojnë edhe një herë ekspertët tuaj për t'i vendosur të gjitha, plus edhe ato që thamë këtu që duhen marrë në kontroll edhe ndërtimet nëntokësore, se kjo përbën rrezik të madh. Nuk dua ta përhap si panik këtë, sepse nuk është. Këtë nuk po e them politikisht, por aty ku është zona më e madhe e panikut do të shkoj të rri vetë, por ju jeni administrata dhe së bashku me ne marrim para nga ky shtet, nga taksapaguesit. Ne duhet të jemi shumë të përgjegjshëm kur e sjellim këtu për ta bërë këtë ligj, i cili është bërë 8 ditë mbas asaj që ndodhi. Pra, mos duhet një kohë pak më e gjatë që ekspertët tuaj dhe Instituti i Ndërtimit të marrin vendime që të mos kalojnë si vendimet e tjera që bënë atë krahurë me 50 e ca të vdekur? Dakord, nuk mund të parandalojmë pasojat e natyrës apo të Zotit, por disa gjëra që janë në dorën tonë duhet t'i ndalojmë. Ne duhet të

shkojmë e të kontrollojmë të gjitha minierat në aksin poshtë. A keni dërguar ndonjë njeri? Ju ndoshta nuk keni përgjegjësi, sepse i takoni një sektori tjetër, por ne duhet t'i tronditim edhe të tjerët që të shkojnë e të kontrollojnë dhe të shikojnë se çfarë ndodh atje poshtë, te burimet e urithit. Këtë shprehje nuk e kam thënë kot, nuk e kam thënë të qesh dikush, unë kam përgjegjësi dhe e them këtu te ju.

Pra, mos ky ligj duhet përpunuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Shtjefni, e di që jeni jurist i shkëlqyer...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Avokat, të lutem se po flas. Unë dua që të vë në lëvizje edhe administratën tuaj dhe të shkundet, që të shikojnë me shumë kujdes jo vetëm objektet mbi tokë, të cilat i ndiqni dhe i shikoni, e përsëris që kam konsideratë për ju si ekspert, por edhe për mbiemrin tuaj, por edhe ata nën tokë. Po ju lutem, ta marrim seriozisht, sepse nesër kur të humbasë ndonjëri shtëpinë dhe të futet në një gropë, sepse ajo e kuçedrës nuk është gjë fare.... Ju ndoshta nuk e dini, sepse jeni i ri, por në zonën e autostradës në vitin 1973 ka pasur cedim dhe fushat kanë ikur poshtë, pikërisht aty ku janë disa kompani të mëdha. Ne nuk duam t'i trembim ata, por duhet të shkojmë me ekspertët tanë për të parë se si është situata dhe gjendja. Nëse ne nuk e shikojmë këtë, ne nuk kemi bërë detyrën tonë si qytetarë dhe të lëmë pastaj pagesat që marrim nga taksapaguesit tanë.

Ju falënderoj! Më mirëkuptoni për tensionin e zërit që përdora në këto momente.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Konomi!

Artan Shkreli – Të përgjigjem me dy fjalë?

Niko Peleshi – Dakord.

Artan Shkreli – Këtë e them me sinqeritet dhe e mirëkuptoj shqetësimin tuaj, sepse ky është një shqetësim i të gjithë tryezës. Ngjarja që ka ndodhur ka qenë shumë e rëndë dhe është e patolerueshme që të përsëritet një ngjarje e tillë pa u marrë masa.

Më vjen mirë që edhe grupet parlamentare, pavarësisht ndarjeve, pra nga cila anë e tryezës janë, e shikojnë me shumë preokupim këtë ngjarje. U zgjata me këto dy fraza, sepse nuk më takon t'i them, por dua të them që sensibiliteti është shumë i lartë.

Ky rregullim ligjor, i cili ka vetëm një nen në thelb, ku bëhet fjalë për objektet mbi 50 vjeçare duhet t'i nënshtrohen auditimit, i hap rrugën, pra e ezauron dhe kjo është shumë e vërtetë. Kjo i hap rrugën marrjes së masave të tjera ligjore, pra pa u bërë kjo nuk mund të përpunohen rregullore dhe as t'u hapim rrugë shumë rregulloreve të tjera që do të përcaktojnë

të gjitha ato pyetje që u bënë këtu, pra nivelin e ndërhyrjes, koha në të cilën bëhen, buxhetet që u përkasin edhe bashkive. Në fund të fundit, vërtet janë buxhetet e bashkive, por ato kanë lidhje me pushtetin qendror. Pra, ky ligj, ku ne shtojmë paragrafin që objektet e vjetra, nuk po përmendim vitet, duhet të auditohen, i hap rrugën të gjithë asaj që thatë edhe ju.

Niko Peleshi – Po, zoti Konomi.

Ardit Konomi – Faleminderit!

Unë një pjesë të përgjigjes e mora, por kam diçka në lidhje me subjektet që parashikohen t'i kryhet auditimi teknik. Me aq sa kuptoj nga konteksti bëhet fjalë për subjekte jo shtetërore, pra dua të di se si është parashikimi pak a shumë për këto?

Ky projektligj prek nevojën e kontrollit të qëndrueshmërisë strukturore të objekteve, sepse merr shkak nga tërmeti, por, duke parë se ka edhe fatkeqësi të tjera natyrore, si zjarri e të tjera, kryesisht në objekte kolektive dhe objekte publike, ndoshta do të ishte me vend që të parashikoheshin edhe masa të tjera brenda këtij ligji, sepse nuk është vetëm tërmeti ai që rrezikon jetën e njerëzve. Pra në këto objekte të jetë prezenca e shkallëve të shpëtimit ose me mënyra të tjera se si mund të trajtohet ky problem.

Artan Shkreli – Ne kemi ligjin e masave kundër zjarrit, i cili është shumë i mirë. Pra presupozohet që nga koha e miratimit të këtij ligji objektet që bëhen tani janë në një cilësi shumë të lartë ndaj këtij rreziku, i cili ka ardhur në rritje në Shqipëri për shkak edhe të përdorimit të mjeteve të tjera alternative të energjisë. Por me auditim nuk kam parasysh vetëm qëndrueshmërinë statike, unë thashë që kjo do të jetë shtylla kryesore ku do të mbështetet udhëtimi, por të gjitha gjërat që rrezikojnë jetën e njerëzve, kjo ka të bëjë me daljen e emergjencës, jo vetëm nga zjarri, por edhe në rast bllokimesh të natyrave të ndryshme.

Për sa u përket çështjeve se si reagojnë apo funksionojnë me emergjencat vende të tjera, vende të ndryshme kanë ligje të ndryshme. Për shembull, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës objektet kanë shkallë të jashtme, sepse e kanë të egër ligjin e evakuimit. Por ka shtete të tjera si Italia që ecën shumë më ngadalë në këtë drejtim, pavarësisht se ligjet i kanë shumë të forta, kohën e rikuperimit e kanë shumë të gjatë. Ata kanë objekte mbi 5 kate që nuk kanë ashensor, megjithëse ligjin e kanë shumë të fortë dhe për personat që nuk kanë mundësi të lëvizin, kërkohet ashensori për t'u ngjitur në katet e larta.

Këto janë specifikime teknike shumë të domosdoshme, prandaj e thashë që ky ndryshim ligjor do të pasohet me hartimin e një rregulloreje, ku do të shikohet se çfarë do të thotë auditim. Kur pyeta se sa thellë do të shkojë auditimi, nuk kisha parasysh auditimin për qëndrueshmërinë statike të objektit, sepse ai do të bëhet i plotë, por sa thellë do të futet dhe çfarë gjërash të tjera do të parashikojë përveç anës statike, ku një nga elementet themelore ka të bëjë me sigurinë e

objektit dhe të jetës së njerëzve. Ky është thelbi i rregullimit të këtij ligji, sepse janë të lidhura bashkë, por edhe ndaj zjarrit apo elementeve të tjera që mund të provokojnë ndonjë shkatërrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ma përsërisni edhe një herë pyetjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të jenë të gjitha shtetërore dhe private, pra nuk janë të ndara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç tha edhe zoti Shkreli, për shkak të sensibilitetit dhe rëndësisë, të gjithë kolegët janë të interesuar që në këtë projektligj që po diskutojmë sot, të merren në konsideratë të gjithë problematikat që kemi ndeshur këta muajt e fundit nga tërmeti. Pra, këto shqetësime të pasqyrohen për të parandaluar në të ardhmen probleme apo dëmtime si këto që pësua.

Kur fillova relatimin, shqetësimi i parë ishte: në projektligj a adresohen dhe a u jepet përgjigje shqetësimeve, problemeve, sfidave me të cilat u përballëm në fushën e ndërtimit në të dy tërmetet, sidomos në atë të 26 nëntorit?

Duke menduar që mbase ministria do të ishte mirë të sillte projektet e reja që ka në mendje, të cilat mund të vijnë për ta plotësuar këtë projektligj, në mënyrë që ligjin ta kalojmë sa më të plotë dhe ju do t'ju ndihmonte në punën tuaj. E kuptoj që është e rëndësishme ta kalojmë sa më shpejt që t'ju ndihmojmë, por duke dashur që të bëjmë një ndryshim të plotë të projektligjit menduam që, nëse keni në ministri ndryshime të tjera, mund t'i sillni tani që po e diskutojmë në komision që ta plotësojmë dhe, kur ta kalojmë në parlament, të jetë i plotë dhe t'u përgjigjet të gjitha këtyre problematikave.

E dyta, mbase lidhet me nene të veçanta të projektligjit, por unë si relatore do t'i them tani, edhe për t'i paraprirë diskutimit që do të kemi nen për nen. E para, ka të bëjë me faktin e auditimit teknik, të cilin ju e referoni. Një nga nenet, në mënyrë eksplicite, flet për auditimin teknik dhe unë mendoj që përkufizimit të tij duhet t'i shtohet listës së përkufizimeve të ligjit, në mënyrë eksplicite, se çfarë do të thotë auditim teknik. Kjo që t'i referohemi me ndryshimin që ju paraqisni për objektet e ndërtuara mbi 50 vjet. Pra këtij projektligji t'i shtohet ky përkufizim. Besoj se specialistët dhe juristët tuaj së bashku me juristët e parlamentit mund të bëjnë një përkufizim që të pasurohet ky projektligj.

Për sa i përket auditimit teknik, nuk është e qartë në ndryshimin që keni sjellë nëse do të bëhet nga auditues teknik të licencuar apo jo. Në projektligjin ekzistues kemi veprimtaritë e projektimit, zbatimit të punimeve në ndërtim, të gjithë kolaudatorëve, të cilët janë të licencuar.

Pra, për audituesit teknik, nuk është e thënë në mënyrë eksplicite nëse do të licencohen, nëse do të ndryshojë ligji i licencimit, apo do të përfshihen në kategoritë e punonjësve që do të licencohen apo jo.

Këtyre ndryshimeve që ju paraqisni unë do t'u shtoja edhe një propozim ose një mendim si relatore, është një çështje që mund ta diskutojmë. Së fundi qeveria ka miratuar me VKM sigurimin e ndërtesave. Unë kam vënë re që ka një periudhë që nga fillimi i ndërtimit deri në momentin që ndërtesa përfundon dhe i dorëzohet qytetarit apo institucionit ka një hapësirë, e cila ngelet e pambuluar me siguracion. A e keni menduar? A është diçka që ne, meqenëse jemi në diskutim të projektligjit, mund ta parashikojmë dhe ta vëmë në ligj që të jetë më e lehtë për t'u zbatuar apo mund të bëhet në VKM-në që keni miratuar dhe të ndryshohet aty? A e konsideroni të rëndësishëm, të domosdoshëm dhe si mund ta bëjmë së bashku këtë gjë, qoftë në projektligj, qoftë edhe në vendimin e Këshillit të Ministrave?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Beqaj ka diçka për të thënë.

Ilir Beqaj – Së fundi kemi rregulluar sigurimin e ndërtimit, por pasi është marrë dokumenti teknik, pra pasi ka mbaruar ndërtimi, ajo që quhet certifikata e përdorimit.

Ligji i territorit i vitit 2014 e vuri si detyrim. Në mos gaboj ka dalë një VKM në vjeshtë, që ka filluar të zbatohet. Do të thotë se pasi dikush i merr shtëpinë, për 10 vjet, ajo është e siguruar nga vetë ndërtuesi. Por kemi edhe një pjesë, siç e tha kolegja, që nga marrja e lejes së ndërtimit, kur fillon punë, derisa të mbarojë, dikush ka një vepër 2 vjet, dikush 3 vjet, varet nga natyra e veprës, për arsye investimesh. Nëse në këtë moment unë lidh një kontratë porosie me një zhvillues, zhvillohet prona, por mund të pësojë një dëmtim në zhvillim e sipër dhe mbetet e pambrojtur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse nuk e mbulon ti? Nëse ne vëmë një kusht, duhet ta mbulojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Berti, kalojmë nga ndërtuesi.

Rruga Tiranë-Elbasan, në zbatim e sipër, 4 herë ... Kush e mbron interesin e investitorit.

Robert Bitri – Ai që ka firmosur për cilësinë e studimit gjeologjik, studimit termik, projektit, duhet t’i kishte marrë parasysh. Nëse ai nuk parashikon në projekt të gjitha gjërat siç duhet, do të mbajë përgjegjësi. Vetëm projektuesi. Kur të vendosë firmën, ta shikojë mirë, do të mbajë përgjegjësi apo jo.

Ilir Beqaj – Ka projektues, ka edhe zbatim punimesh. Janë të gjitha bashkë.

Bota i siguron edhe kantierët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ç’rëndësi ka?

Robert Bitri – E siguron ai që e ndërton.

Ilir Beqaj – Po.

Unë po propozoj...

Robert Bitri – Ai që e ndërton, nëse nuk e siguron, e mban vetë përgjegjësinë.

Ilir Beqaj – Mund të mbaroj?

Artan Shkreli – Zoti Beqaj, e kuptova idenë tuaj.

Sigurimi i kantierit te ne nuk bëhet. Bota e ka sigurimin e kantierit, por nuk e ka për defekt apo për diçka tjetër, por për të mos qenë gërmadha. Ka shumë ndërtues që për një motiv apo për një tjetër e lënë objektin përgjysmë për 10-20 vjet. Ky ka qenë thelbi, sepse unë kam marrë pjesë në një diskutim të tillë në një konferencë ndërkombëtare që u bë për sigurimin e kantierëve. Sigurimi i kantierit, për efektin e dëmit që pëson objekti, e gjithë përgjegjësia është e ndërtuesit. Më pas, nëse fajin e ka zbatimi apo projekti, gjendet, nuk mund ta rregullojmë këtu. Mendoj se sigurimi i kantierit duhet, sepse i jep garanci shumë të madhe pushtetit vendor që i jep lejen, përdoruesit që ka derdhur një pjesë të parave dhe objekti nuk mbaron kurrë, por jo për efekt dëmtimi.

Ilir Beqaj – Unë mendoj se ne kemi një boshllëk në sigurimin e veprës gjatë ndërtimit të saj. Këtu e pëson shteti, kur është ai investitor i veprave të mëdha, sepse të gjitha veprat e mëdha kanë dalë me defekte, me rrëshqitje, por edhe koha e humbur nga zbatimi, edhe ndërtimi privat, në fund të fundit.

Pra, kam porositur një apartament. Kur fillova ta ndërtoja, ndodhi diçka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai e ka përgjegjësinë, por bota ndaj i ka shpikur instrumentet e sigurimit.

Unë mendoj se për çdo lloj marrëdhënie që dikush merr përsipër, kur shkon të sigurohet, agjenti i kompanisë së sigurimit do të mendohet edhe një herë, sepse është kompania e sigurimit.

Sot, mendohet që kompanitë shqiptare të sigurimit do të paguajnë 19,4 milionë euro vetëm nga tërmeti i 26 nëntorit dhe 90% është për meritë të bankave, jo të dëshirës apo pjekurisë së individit për t'u siguruar. Bankat kanë siguruar kreditë. Në fund të fundit, ç'rëndësi ka? Ndodhi e keqja një ditë.

Meqenëse ky ligj rregullon punimet e ndërtimit, pyetja ime është: gjatë fazës së punimeve, pa u lëshuar certifikata e përdorimit, a mendoni se ka hapësirë për të futur elemente të sigurimit, të përgjegjësive ndaj palëve të treta?

Artan Shkreli – Unë po shpreh një konsideratë personale, meqenëse pyetja u bë direkte dhe nuk kam mundësi ta konsultoj.

E mendoj absolutisht si ju. Kantierët duhen siguruar. Në çfarë mase dhe si, mund të kërkojë një debat të mëtejshëm edhe me grupet e interesit, por është absurde të kesh kantierë të pasiguruar. Në Perëndim unë kam parë kantierë që nuk futesha dot nëse nuk bëja një sigurim të shkurtër jete, sigurim jete 24 orësh, sepse po të shkel një gozhdë, hedh në gjyq kompaninë. Nuk të lejojnë të hysh nëse nuk ke kasën speciale, këpucët e te tjera. Sigurimi i kantierit rregullon shumë gjëra. Kantieri është një perimetër ku nuk futet kushdo. Në Shqipëri futet kushdo, hap derën, zihet me rojën e të tjera. Në këtë pikëpamje sigurimi i kantierit është shumë i rëndësishëm, por e theksoj, jo për efektet e dëmeve që vijnë si rezultat i zbatimit, por sigurimi i kantierit në përgjithësi. Pra, për çfarëdo lloj dëmi që shkaktohet në kantier nga forca madhore, të cilat përfshihen ose jo, apo edhe nga gabime njerëzore, objekti është i siguruar, kjo mund të ndodhë si rezultat i falimentimit të firmës, që e ka lënë përgjysmë, ka lënë kreditorët apo debitorët në ajër, apo si rezultat i vënies në konfiskim nga shteti, për shembull, ne vumë dy kullat te bulevardi në konfiskim nga shteti kur ishte një ligj për terrorizmin islamik, ku unë kam qenë aktor në këtë histori, sepse duhet të bëja një ekspertizë, dhe ato ndenjën disa muaj, por më pas u thanë se nuk janë terroristë dhe vazhduan ndërtimin, por ndërkohë, njerëzit kishin paguar lekët. Unë e përkrah këtë ide. Nuk e di nëse duhet të bëhet një pauz, që ta konsultojmë me grupet e interesit dhe me ministrinë, pasi nuk është diçka e vogël që kalon me një “po” ose “jo”, pasi sigurimi i kantierit është diçka e rëndësishme. Këtu nuk flitet për objekte që do të auditohen, që janë 60-vjeçare, që janë shumë pak në raport me objektet e reja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është diçka shumë e rëndësishme, por e konsideroj të domosdoshme.

Niko Peleshi - Zoti Musaj dhe më pas zoti Bitri.

Nimet Musaj – Faleminderit, kryetar!

Ndoshta shqetësimi është i madh.

I nderuar zëvendësministër, unë do ta lidh me zonën naftëmbajtëse nga vij, ku ardhja e kompanive të fuqishme në shpim-kërkimet me teknologji të re ka sjellë pasoja në atë zonë. Berti është pjesë e saj dhe e di mirë çfarë ka ndodhur, sepse ka qenë prezent, jo ju të tjerët. Ju mund të mos më ktheni përgjigje, zëvendësministër, por unë do ta shtroj si problem dhe ta shikojmë në vazhdimësi. Për një periudhë atje ndodhnin “tërmete” masive të përditshme dhe të gjithë thoshin janë tërmete, por ato vinin nga teknologjia e shpimit që bënin këto kompani për nxjerrjen e naftës. Jemi te pjesa e fatkeqësisë natyrore, që nuk kemi çfarë t’i bëjmë, por pjesës që vjen nga dora e njeriut, që ne e kemi pasur në dorë, për 50 milionë lekë të rinj, e kam thënë në parlament, ata banorë po presin. Nëse kjo kompani që solli këtë dëm, që edhe ju e dini çfarë ndodhi atje, zëvendësministër, do të kishte detyrimin financiar, ata qytetarë, pra banorët e asaj zone, do t’i kishin marrë këto lekë, jo shteti, jo ne, as ju, nuk kemi detyrimin t’u japim lekët. Atë fontanë e bëri kompania kanadeze, ata e bënë, nuk e bëri shteti ynë, nuk e bëri qeveria. Ne po detyrohemi të gjejmë lekët për t’ua dhënë atyre njerëzve, sepse u takojnë. Ajo kompani duhet t’u kishte dhënë 50 milionë lekë të rinj. Nuk janë asgjë për ata, sepse unë vij nga ajo zonë. Madje, duhet t’i thoshte shtetit shqiptar: këtë e bëra unë, unë do ta paguaj, sepse 50 milionë lekë të rinj janë, zoti zëvendësministër. Kur ndodhi fatkeqësia në Zharrës, kur ndodhi fontana...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo për 1 vit, jo për 2 vjet, por për 3 vjet kishte shpërthime ditore. Zëvendësministri ka qenë në Itali, në Aquila, ku njerëzit janë tmerruar kur i kanë dëgjuar, ndërsa ne nuk na bënte përshtypje, sepse ishim mësuar. Ata thoshin: “janë tërmete”. Për kaç lekë kanë ngelur, që të marrin lekët këta banorë. Po në të ardhmen çfarë do të bëhet me atë zonë? Ku do të shkojnë? Ato dëmtime vazhdojnë. Për fat të keq, nëse ky tërmet do të kishte rënë në atë zonë, katastrofa do të ishte shumë më e madhe nga sa ishte sot, për vetë teknologjinë që ka toka në atë zonë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Baraj.

Besnik Baraj - Duke mbështetur shqetësimin e kolegut, do të thosha se kjo tregon edhe pafuqinë tonë në përgjithësi. Jo në këto përmasa, por në përmasa më të mëdha në Gjirin e Meksikës, kur ndodhi nga “British”, u paguan rreth 50 miliardë dollarë, kurse këtu kompania nuk mori përsipër minimumin e asaj që bëri. Unë jam dakord me kolegun, që dëmet janë afatgjate, veçanërisht për ujërat nëntokësore, sepse ato shpërthime kanë gjeneruar ujëra nëntokësore që janë jashtëzakonisht me NaCl, me përqendrime shumë të larta dhe i kanë kontaminuar dhe ato dhe do të duhen shekuj që të rivendoset.

Agron Hysenlliu - Mendoj që kjo nuk mund të jetë pjesë e këtyre ndryshimeve ligjore që kemi paraqitur sot. Mbështes zotin Baraj, në njëfarë mënyrë është deri diku një lloj boshllëku i shtetit për të bërë kontrata siç duhet me këto firma, me sipërmarrjet e mëdha. Aty është çështje kontrate, njerëzit që përpilojnë kontrata të tilla dypalëshe duhet të jenë jashtëzakonisht të suksesshëm, të kujdesshëm, përndryshe kompanitë e mëdha...

Niko Peleshi – Zoti Shkreli, faleminderit!

Të kthehemi pak të ligji. Nëse mund ta përmbledh me një fjali, ky ligj vendos taksativ auditimin për ndërtesat më të vjetra se 50 vjet dhe liberalizon oponencën. Deri dje, nëse e kam gabim më thoni oponenca kryhej vetëm nga Instituti i Ndërtimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, çfarë ndryshon ky nen?

Artan Shkreli - Instituti i Ndërtimit është garanti i oponencave dhe bën kontrollin e oponentëve. Instituti i Ndërtimit nuk mund të bëjë oponencën për të gjitha objektet që ndërtohen në Republikën e Shqipërisë.

Niko Peleshi – E kam ditur që oponencat i bënte vetëm Instituti i Ndërtimit. Këtu thuhet: “Nga institutet shtetërore ose entet e tjera”. Pra, nënkuptohet që oponencat mund t’i bëjnë edhe privatët tani me këtë ligj.

Agron Hysenlliu – Po, kështu ka qenë.

Niko Peleshi – Kështu ka qenë, nuk ka ndryshim?

Agron Hysenlliu – E kanë bërë fakultetet, e kanë bërë edhe drejtori të tjera përveç Institutit të Ndërtimit.

Niko Peleshi - Edhe kompani private?

Agron Hysenlliu - Jo!

Niko Peleshi – Ku kufizohet?

Nuk po flas për praktikën, po flas se çfarë hapësirash krijon apo mbyll ky projektligj. “Nga institutet shtetërore ose entet e tjera”, “ente të tjera” nuk nënkuptohen ato shtetërore, nuk është e specifikuar. Nëse ju keni pasur parasysh shtetëroret, kur të kalojmë në miratimin nen për nen...

Agron Hysenlliu - Ato do të dalin më pas me VKM dhe i lihet kompetencë ministrit se cilit do t’ia delegojë e të tjera.

Niko Peleshi - Me fal, por ta mbaroj fjalën. Unë ju prita deri tani.

Agron Hysenbelliu - ... i lihet kompetenca ministrit të linjës se cilit do t’ia delegojë për ta bërë oponencën teknike. Institucioneve shtetërore po, Institutin e Ndërtimit e ka me

ligj, por edhe enteve të tjera që mund të caktohen nga ministri i linjës, duke parë kapacitetet që ka Instituti për t'i kryer ato.

Niko Peleshi – Pyetja ime, përcaktohen nga ministria, por mbi çfarë kriteresh? VKM-ja duhet të respektojë disa kritere. Cilat janë kriteret që ndiqen nga ministria për të përcaktuar institucionet, entet publike apo private që kryejnë oponencat? A mos ju ka lindur në praktikë nevoja për të përcaktuar një kuadër kriteresh?

Agron Hysenlliu – Kuadrin e kriterëve se si kryhet një oponencë teknike e përcakton ligji nr. 1055 dhe ato subjekte që plotësojnë këto kushte, ministria i vë në dispozicion për ta kryer këtë oponencë teknike.

Niko Peleshi – Sa vlerësohet, nëse keni një vlerësim paraprak numri i objekteve që mund të jenë mbi 50 vjet? Një vlerësim me sondim.

Agron Hysenlliu - Në 100 mijë banesa që janë sot në Shqipëri, rreth 40-50% e tyre janë banesa që janë mbi 50 vjet.

Niko Peleshi - Në kuotë absolute sa janë?

Agron Hysenbelliu - 50 mijë banesa.

Niko Peleshi - Ju thatë që ekzistojnë kapacitetet njerëzore për të bërë këtë vlerësim në një kohë optimale.

Agron Hysenlliu - Ekzistojnë kapacitet, po flas pak retorikë, nëse nuk ekzistojnë kapacitetet është domosdoshmëri që të krijohen.

Niko Peleshi - Kam një pyetje tjetër. Këtu flitet për auditimin teknik, ekziston profesioni i audituesit teknik, a është i rregulluar në ndonjë ligj? A është e përcaktuar licenca, certifikata, kush e lëshon e të tjera? Çfarë kushtesh duhet të plotësohen që të licencohesh si auditues teknik?

Artan Shkreli - Dua të sqaroj pak më tepër. Vetë oponenca teknike është institucion, në koncept. Ajo ka 7 shtylla. Nuk ka të bëjë vetëm me një profesion, por ka të bëjë me disa të tilla, prandaj është edhe Instituti i Ndërtimit për ta kryer këtë oponencë teknike. 7 shtyllat, duke përfshirë anën juridike, ekonomike, elektrike, mekanike, zjarri, uji, efienca e energjisë që janë të përfshira brenda oponencës teknike që kryhen në një projekt, e cila është në total e gjithë tekstura e oponencës teknike. Këto institucione që duhet të kryejnë oponencën teknike duhet t'i kenë këto shtylla brenda vetes. Oponenca teknike duhet të certifikohet nga një institucion që të marrë një markë, le të themi, që u certifikua nga Instituti i Ndërtimit ose nga një institucion tjetër. Në këtë aspekt kërkohen institucione, pavarësisht se mund të jenë shtetërore apo private.

Niko Peleshi - Edhe për auditimin teknik të objekteve...

Agron Hysenlliu - Oponenca teknike, do të thotë në vetvete auditim teknik.

Niko Peleshi – Zoti Shkreli, kështu është edhe sipas jush?

Konfondohet, nëse oponenca teknike dhe auditimi teknik është e njëjta gjë, atëherë pse e fusim si koncept?

Artan Shkreli – Nuk homogjenizohet për motivin se oponenca është një objekt, i cili vjen i mirëqenë, që ky është projektuar në rregull dhe për ta bërë të besueshëm, një institucion verifikon nëse është bërë në rregull apo jo. Kjo quhet oponencë, sepse ke një projektues apo një ent, i cili do të zhvillojë një objekt dhe thotë: “Ky është projekti im, është në rregull”. Ti duhet ta kontrollosh duke bërë oponencën. Në rastin konkret është auditim, sepse është një objekt për të cilin askush nuk jep garanci për atë objekt. Në thelb nuk është oponencë, pavarësisht se elementet e kontrollit janë të njëjta. Termi nuk mund të jetë i njëjtë. Veprimi është pothuajse i njëjtë, por bëhet për qëllime të ndryshme.

Agron Hysenlliu - Nëse më lejoni, kam edhe diçka. Oponenca teknike mund të quhej auditim teknik për projektin e ri, ndërsa kjo kryhet për objektet e vjetra, prandaj quhet auditim, sepse mund të quhej edhe oponencë për objektet e vjetra, ka të bëjë me atë që është e krijuar dhe do të shihet sesi e ka performancën. Në thelb pothuajse janë njëloj, pavarësisht se ne e kemi konsideruar në terminologji që të themi oponencë për atë që është e re, pasi është një produkt intelektual dhe ne do ta shikojmë në bazën e kushteve teknike dhe është diçka tjetër që kjo do të auditohet pasi do të kryhen prova dhe gjëra të tjera brenda strukturës së një objekti.

Niko Peleshi - E kuptova, por sipas VKM-së nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” është fiksuar te pika 2, që për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit oponenca teknike do të bëhet nga subjekte publike, studimore shkencore të miratuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit. Nëse është kështu siç thoni ju auditimi teknik dhe oponenca janë pak a shumë e njëjta gjë, në kuptimin shkencor të fjalës dhe kryhen nga institucione, i bie që një numër shumë i vogël institucionesh që mund të jetë instituti juaj, ndonjë universitet dhe nuk e di se cili tjetër të kryejnë 50 mijë auditime.

Agron Hysenlliu - Ne kemi edhe praktikën e tërmetit që po bëjmë tani, pra po kryhen auditimet dhe po bëjmë analizat e thelluara, ekspertizat e thelluara, por mendoj që janë institucionet që duhet ta kryejnë dhe...

Niko Peleshi - Jam dakord, por pyetja është: 2-3 institucione brenda një kohe optimale, a i kryejnë dot 50 mijë auditime?

Agron Hysenlliu - Patjetër! Ne kemi të drejtën si institucione që të thithim brenda vetes me kontrata të gjithë inxhinierët që janë të licencuar dhe mbi bazën e tyre kryejnë auditimet përkatëse. Kjo nuk do të thotë që unë duhet të kem 4 mijë veta në Institut, duke qenë se lidh kontrata për një projekt të caktuar, kam projektin që ma jep VKM-ja dhe mbi bazën e këtyre unë kryej të gjitha auditimet që duhet të kryhen në terren. Quhet auditim se kryhet në teren, po të ishte në letër, quhet oponencë.

Niko Peleshi - Kam edhe një pyetje të fundit, por më parë do t'ia jap fjalën zotit Beqaj.

Ilir Beqaj - Faleminderit, se më në fund edhe ne u sqaruam, që oponenca është mbi projektin, mbi letra dhe auditimi është mbi objektin konkret.

Po kthehem pak te neni 6, ligji ekzistues thotë: “ Oponencë për çdo ndërtim mbi 100 milionë”. Ju vini tani dhe i ndani në 3 grupe: publike, me akses publik dhe jopublike. Me sa lexoj këtu te publiket, kopshtet, çerdhet dhe te ato me akses publik nuk doni tavanin 100 milionë. Te ndërtimet jopublike, siç ka qenë e keni lënë 100 milionë, po themi një qendër rezidenciale e të tjera. Ky është thelbi i asaj...

Ilir Beqaj – Më fal!

Agron Hysenlliu – Po, ky është thelbi. Ne nuk e kemi lëvizur ligjin. Atë 100-milionëshin e kemi lënë ashtu siç ka qenë, sepse konsiderojmë se është e drejtë që ato duhet të kryhen, dhe do të kryhen, por ne kemi menduar se duhet të kryhen edhe ca të tjera, që kanë akses në kopshte, çerdhe, shkolla, për shembull, ndaj të cilave kemi sensibilitet shumë të madh.

Pavarësisht se ajo shkolla mund të mos e ketë atë lloj vlere, 100 milionë, sepse mund të jetë nën 100 milionë, duhet patjetër ta kontrollojmë nga ana teknike, nëse janë kushtet. Sepse, kur bëra pak më parë atë rezymenë, dhe thashë se oponenca teknike është institucion që ka shtatë shtylla, një nga këto shtylla është ngrohja brenda shkollës, e cila a është futur në oponencë teknike? Zjarri është futur? Kjo pavarësisht se nuk e plotëson 100-milionëshin.

Në këtë aspekt, ne kemi kërkuar të përmirësojmë ligjin pikërisht aty ky janë gjasat të kryhet dëmi më i madh në një banesë.

Niko Peleshi – Dakord, po me këtë hapje kaq të madhe, pra nga njëra anë shtojmë 40 mijë-50 mijë objekte për audit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ngarkesa bie të njëjti institucion, te Instituti i Ndërtimit dhe te universiteti.

Nga ana tjetër heqim dyshemenë 1 milion dollarë, 100 milionë lekë të reja për objektet publike dhe objektet me akses publik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër. Janë gjithë ato objekte të bashkive, për shembull, objekte publike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Hysenlliu – Po, një institucion i qëndron vetëm për të certifikuar.

Niko Peleshi – Tani, edhe një objekt me një vlerë 30 mijë dollarë, po themi...

Agron Hysenlliu – Në qoftë se është 30 mijë dollarë dhe ka akses publik, për shembull një çerdhe, që mund të ketë 40 vetë brenda, është e detyruar të vijë tek ne.

Niko Peleshi – Dakord, por a e kuptoni se sa shumë rritet ngarkesa për ju?

Agron Hysenlliu – Patjetër që duhet. Na e ngarkoni, sepse e mbajmë. Duhet bërë.

Niko Peleshi – Dakord, po kur të krijohet kolapsi, ju do të thoni...

Agron Hysenlliu – Nuk ka problem, sepse ne do të marrim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, Agroni s'ka ikur, Agroni do të jetojë 100 vjet.

Niko Peleshi – Jo, jo, ka ikur nga institucioni, me ngritje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Hysenlliu – Është VKM-ja 354, që rregullon tarifat. VKM-ja 354...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tarifa 354, për oponencën teknike në lidhje me ato që ne kërkojmë, nuk ka vlerë monetare fare. Ligji nr. 354 për oponencat teknike në lidhje me këto që kërkojmë ne nuk ka fare vlerë monetare, është pothuajse minimale për një institucion, por ka akses të madh publik, pasi kontrollon këto lloj objektivash dhe i detyron të shkojnë në parametra e kushte teknike, të cilat përcaktohen nga kodet dhe eurokodet.

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi ka fjalën. Pastaj zoti Bitri.

Arben Pëllumbi – Ju falënderoj, sepse më në fund po fillojmë të kemi pak qartësi edhe ne në lidhje me këtë që propozohet e atë që bëjmë. Gjithsesi, vazhdon të na ngelet ende një lloj shqetësimi edhe në kuadër të asaj që tha kryetari, por edhe të pyetjes që unë bëra. Tashti jemi të qartë se certifikimi final për oponencën finale, firmën finale do ta jepni ju ose një fakultet. Pra, do ta japë një institucion shtetëror.

Sigurisht, në këtë gamë shumë të madhe, që tashmë zgjerohet, duke futur edhe këto kategoritë e tjera, duke hequr edhe dyshemenë e këtyre kategorive, sepse jemi të qartë se shtohen rreth 50 mijë objekte, ju do të keni nevojë të thithni kapacitete private të licencuara.

Në rregull, shumë mirë, po brenda këtyre kapaciteteve private, dhe ky është shqetësimi që lind në këtë moment, a do të jeni ju në gjendje që t'i kontrolloni të gjitha këto kapacitete private, që në fund fare ato të marrin vulën shtetërore, apo do të ngarkojmë shtatë specialistë,

nga një inxhinier për çdo fushë, që të kontrollojë ca objekte atje, ndërsa ju thjesht do t'u jepni një ok në fund?

Këta privatët që do të punojnë në emrin tuaj, a keni ju kapacitetet e duhura për t'i mbajtur nën kontroll?

Agron Hysenlliu – Zonja Gjermani ka qenë ministre dhe e di shumë mirë si funksionon Instituti i Ndërtimit, si dhe që të gjitha kapacitetet që vijnë te Instituti i ndërtimit janë të miratuara nga ministria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të lutem!

Ata janë që të gjithë me grada shkencore dhe janë ajka e inxhinierisë së ndërtimit në Shqipëri. Mua si institucion më takon të bëj pjesën time, që quhet kontrolli shtetëror mbi këto lloj problematikash. Unë këto i kam të ngritura me departamentet që kam brenda, dhe mund t'i shtoj departamentet. Problemi është se derisa funksionon me ekonomi tregu, ka një buxhet të caktuar, atëherë çdo gjë kryhet, sipas konceptit që kam unë.

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Drejtor, unë e kuptoj këtë gjë, në mënyrë të padiskutueshme. Unë jam edhe vetë inxhinier në profesion, kështu që ju mirëkuptoj në të gjitha, por do të doja të dëgjoja më shumë nga ju, që thoni se do të keni nevojë qoftë këtë vit apo vitin që vjen, për buxhete shtesë, që ta rrisni institutin, do të na qetësoje më shumë kështu, se sa duke na thënë se i kam kapacitetet sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Të lutem Agron, të lutem!

Agron Hysenlliu – Më fal!

Niko Peleshi – Për sa kohë mendoni se duhet të përfundojë ky auditimi i ndërtesave më të vjetra se pesëdhjetë vjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Hysenlliu – Unë nuk kam një datë, siç e tha edhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ju si mendoni?

Agron Hysenlliu – Unë mendoj se nga sot, që jam në terren, po auditoj, sepse auditim është kjo që po bëj, ekspertizë e thelluar për tërmetin, për tre muaj duhet të mbyll një kapacitet prej rreth 1050 pallatesh, dhe rreth 8000 banesash të vogla.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, të lutem, nuk e bëra këtë llogari.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj se ne duhet të fillojmë. Në hapat e tjerë, problematika mund të mos jetë vetëm Instituti i Ndërtimit. Ka edhe institute të tjera. Ka institut Transporti, ka institute të tjera. Mund të ndahet gama e objekteve të ndërtimit, siç janë urat, për shembull, për të cilat foli zotëria.

Instituti i Ndërtimit ka marrë pjesë në një auditim që u është bërë të gjitha urave në Shqipëri, dhe ka nxjerrë një raport përkatës. Kjo detyrë mund të mos i vihet Institutit të Ndërtimit, por mund t'i vihet Drejtorisë së Transporteve dhe Institutit të Transporteve. Kjo është çështje e menaxhimit të ministrisë.

Problemi është ky: për fondin e banesave që kemi, po të fillojmë sot, me kapacitetet që kemi dhe me njerëzit që janë në treg, ne mund t'i bëjmë deri në katër pesë vjet. Por ama duhet filluar, se nuk kemi filluar. Është e rëndësishme të fillojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet ligji patjetër.

Niko Peleshi – Zoti Bitri.

Robert Bitri – Te objektet me akses publik, që janë rreth 40-mijë-50 mijë, që ne themi se janë çerdhe, kopshte etj. Po ndonjë pallat që ka 200 banorë, 300 banorë?

Agron Hysenlliu – Po, edhe banesa është akses publik në vetvete. Në qoftë se nga ata që sjellin projektet për miratim tek ne, sepse oponenca teknike jep rekomandim në lidhje me projektin, që s'duhet bërë kjo, duhet bërë kjo e kjo, pra në qoftë se ata, kur të shkojë për miratim, do ta quajnë si objekt me akses publik, atëherë janë të detyruar ta sjellin edhe atë që është nën 100 milionë, por në këto që kanë 300 banorë apo 400 banorë, nuk është më e vogël se një milion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi thënë për këto që na e kalojnë, një herë, të cilat kanë edhe sensibilitet më të lartë.

Artan Shkreli – Edhe një gjë kisha unë. meqenëse tashmë është liberalizuar tregu, çerdhe, kopshte, shkolla e të tjera, duhet të kemi parasysh një gjë: edhe një objekt që nuk e ka kaluar certifikimin, ministria përkatëse, që në rastin konkret Ministria e Arsimit, do të kërkojë certifikim të objektit edhe nëse ai është nën vlerën e 100 milionëve, kur ky objekt ndryshon destinacione, pra nga objekt për përdorim privat, po e quajmë, në objekt me përdorim publik. në këtë moment, futet automatikisht te kllapa e kontrollit, pavarësisht nga shifra me të cilën është bërë. Kur thuhet për objekte private me akses publik, kihen gjithmonë parasysh vendet

me grumbullime masive njerëzish, që do të thotë supermarkete stadiume, se tani privati po i bën të gjitha.

Për objekte të vogla nën 100 milionë, thoni me të drejtë ju, dikush merr një vilë që mund të ketë kushtuar nën 100 milionë dhe bën një çerdhe ku janë 60 fëmijë. Në momentin kur kërkohet licenca nga Ministria e Arsimit, natyrisht kërkohet auditimi i objektit, sepse shndërrohet në një objekt me akses publik.

Niko Peleshi – Një objekt privat prej 50 mijë dollarë investim, një shtëpi individuale, sipas këtij ndryshimi ligjor duhet të marrë gjithashtu oponencën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si, jo?

Agron Hysenlliu – Vetëm në qoftë se ka akses publik.

Niko Peleshi – Në rregull! Rikonstruksioni i një çerdheje: fasada, ndërrimi i çatisë, duhet të marrë oponencë apo jo?

Artan Shkreli – Po. Sapo e shpjegova se, në momentin që një objekt nën 100 milionë ka akses publik, enti i cili e licencon këtë objekt për akses publik, sepse nuk ka akses publik të palicencuar.

Niko Peleshi – Po flas për rikonstrukcione.

Artan Shkreli – Edhe për rikonstrukcion do të shkosh në bashki.

Niko Peleshi – Po pra! Bashkia duhet të vijë te instituti, të bëjë oponencën dhe të vazhdojë me prokurimin, po themi.

Artan Shkreli – E dinë ligjin. Shkon vetë projektuesi ose zbatuesi.

Niko Peleshi – Unë kam eksperiencën e bashkive, që edhe i kanë djegur fondet, për shkak se nuk kanë mbaruar dot oponencën. Sepse fondet e bashkive janë fonde të buxhetit, digjen në fund të vitit.

Mbase kjo është një lloj burokracie e domosdoshme, e nevojshme, nuk jam kundër oponencës, por gjithsesi është një burokraci që shtohet. Kjo mund të na rrezikojë djegien e fondeve, prandaj duhet të jemi një çikë prudentë kur krijojmë hapësirën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Agron Hysenlliu – Sipas meje është e rëndësishme, prandaj edhe e kemi kërkuar, që më mirë të kryhet oponencë teknike, sepse nuk ka vlerë monetare për ta kryer këtë oponencë teknike, por është kontroll. Duke qenë kontroll, është më mirë të shkosh te mjeku e të kontrollohesh, se sa ka vlerë financiare për oponentin. Nuk ka vlerë fare. E thashë: mbi bazën e ligjit nr. 354, me kategoritë e punimeve që futen në të, kur ne i llogarisim, këto lloj objektesh

i kërkojmë vetën nga ana teknike, nuk i kërkojmë fare nga ana financiare, se nuk kanë vlerë financiare.

Niko Peleshi – S’e kisha fjalën aty. E kisha fjalën te burokracia që shtohet në procedurën...

Agron Hysenlliu – Procedura burokratike nuk shkon më tepër se gjashtë ditë, gjashtë deri në dhjetë ditë është.

Niko Peleshi – E di unë, kemi eksperiencën...

Agron Hysenlliu – Jo, jo, gjashtë deri në dhjetë ditë është me ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjashtë deri në dhjetë ditë, e kemi me ligj.

Niko Peleshi – Gjashtë ditë është sot, po kur të kesh pesëdhjetë mijë objekte...

Agron Hysenlliu – Ligji të detyron prapë, dhe unë jam i detyruar të organizoj punën për ta bërë në këtë kohë.

Niko Peleshi – Po të ishte kështu, ne do të ishim vend anëtar dhe i zhvilluar i Bashkimit European, nëse çdo gjë që duhet, bëhet.

Agron Hysenlliu – Për atë po mundohemi.

Niko Peleshi – Në qoftë se ti s’ke mundësi, nëse s’i ke kapacitetet për ta përballuar, çfarëdo që thotë ligji...

Agron Hysenlliu – Unë i kam të gjitha kapacitetet. M’i jepni, dhe do të shikoni si do t’i bëj.

Niko Peleshi – Në rregull!

Agron Hysenlliu – Shefja atje e di shumë mirë, se ka punuar me mua.

Niko Peleshi – Zonja Gjermani ka kërkuar fjalën.

Zonja Gjermani.

Mos u shqetësoni për atë punë fare. Mundohuni t’i sillni, se të tjerat i zgjidh unë.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Unë kërkoj ndjesë se, edhe si ish-ministre, por edhe si deputete e qarkut Durrës dhe e bashkisë Krujë, më takonte të shprehja një falënderim dhe vlerësim të jashtëzakonshëm për punën e institutit në këtë periudhë pas tërmetit, sepse është bërë një punë heroike, duke qenë tepër të impenjuar dhe të angazhuar në të gjithë territorin, nonstop, në Krujë, Durrës dhe në të gjitha zonat.

Sa i përket ngarkesës, edhe unë e kam këtë shqetësim që, duke u ngarkuar me shumë ndërtesa, tashmë kapaciteti është i përcaktuar, ndërkohë që kapaciteti është i përcaktuar dhe ju jeni me vetëfinancim, një pjesë të fondeve e merrni nga institucionet publike, ministri apo

bashki, të cilat jo gjithmonë ju përgjigjen në çast. Mbase kjo pjesë duhet të përcaktohet. Ne e kemi pasur këtë shqetësim që te qeveria “Rama1” dhe mendonim që mbase instituti mund të marrë një pjesë të buxhetit nga shteti dhe të gjitha auditimet teknike që bëhen, për institucionet publike, të mos kishte nevojë të paguhej, se bënte për institucione shtetërore (për shembull, për pushtetin qendror).

Duke qenë se ndryshimet ligjore kushtëzojnë apo janë faktorë që ndikojnë në punën tuaj dhe keni nevojë t’i keni sa më shpejt, unë sugjeroj si relatore të kalojmë në diskutimin dhe miratimin në parim. Besoj se të gjitha shqetësimet tonë janë të drejta, lidhur me situatën që po kalojmë.

Për sa i përket miratimit nen për nen të projektligjit, do të doja t’ju kërkoja që, në rast se keni ndryshime të tjera apo saktësime për projektligjin, apo për nenet që keni sjellë, t’i depozitoni, ndërsa sot të bëjmë vetëm diskutimin dhe miratimin në parim. Në rast se keni përmirësime, saktësime, mangësi të këtyre ndryshimeve, t’i kalojmë një ditë tjetër nen për nen.

Ky është propozimi im.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Nuk është punë vote, është më shumë një pyetje për ministrinë, me sa kuptova.

A e ndjeni të nevojshme të bëni ndonjë plotësim?

Agron Hysenlliu – Nga ato që kemi sjellë, ky negociim është që në shtator të vitit 2014. Gjëja e parë që kam bërë kur kam shkuar në institucion, kam sjellë në ministri këto negocime për të kryer pikërisht këto gjëra që po diskutojmë sot.

Niko Peleshi – Pra, ju jeni të bindur që ky projektligj është i kompletuar dhe duhet të kalojë sa më shpejt.

Ardit Konomi – Mua më duket së në çdo variant që kemi diskutuar deri tani, pika b e nenit 6 është jopërcaktuese, sepse ne këto i përmendim te pika c dhe i përfshijmë të gjitha te c-ja.

Unë mendoj që pika b duhet të përcaktojë ndërtimet për banim kolektiv.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë mendoj se ndërtimet për banim kolektiv duhet të jenë patjetër të përcaktuara.

Agron Hysenlliu – Ideja është që pallatet e mëdhenj me banim kolektiv, ku ka grumbullime të mëdha njerëzish, janë të gjitha mbi 100 milionë. Ato e kanë oponencën e detyruar.

Niko Peleshi – Atëherë, kalojmë në miratimin në parim.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Gjuzi, ministria nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për më shumë kohë për të saktësuar ndonjë nen dhe është e bindur që ky projektligj është i kompletuar, nuk ka lidhje me tërmetin e nëntorit, sepse nuk është një reagim që vjen pas një tërmeti, por është një ligj me ndryshime ligjore të menduara prej kohësh.

Unë propozoj të kalojmë në diskutimin nen për nen. Në qoftë se ngecim në ndonjë nen, në debat me ministrinë, mund të marrim më shumë kohë, por nuk shoh arsye për të mos e filluar diskutimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? 1 abstenim i zotit Gjuzi.

Miratohet.

Neni 2.

Ky nen shton te neni 4 i ligjit bazë nenin 4/1, si më poshtë: “Të gjitha objektet, të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar i nënshtrohen procesit të auditimit teknik. Rregullat për mënyrën se si do të zbatohet auditimi dhe cilat do të jenë subjektet që do ta kryejnë atë përcaktohen me VKM”.

Urdhëroni, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Këtu thamë disa herë pjesën e përkufizimit të auditimit teknik. Nëse vërtet në projektligj e referojnë këtë, ekspertët e dinë dhe përdorin si terminologji, por unë besoj se ligji nuk është vetëm për ju, prandaj mendoj se duhet një përkufizim se çfarë do të thotë “auditim teknik”.

Në ligjin ekzistues nuk është dhe mendoj ta përkufizojmë tani.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj - Përveçse mbështes çfarë sugjeroi kolegja dhe teknikisht mund të përdorim atë teknikë që keni përdorur ju në nenin 6, se për fat të keq ku ligj nuk ka nen përkufizimesh.

Siç keni thënë te neni 3: “me objekt dhe akses publik kuptojmë”, edhe këtu themi: “me audit teknik kuptojmë”.

Përveç kësaj, unë sugjeroj që edhe nenit t’i vëmë titull.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, tërhiqem.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Konomi!

Ardit Konomi – Duke pasur parasysh kohëzgjatjen që do të duhej për vlerësimin e të gjitha auditiveve të këtyre objekteve, ndoshta do të ishte me vend që ky nen të plotësohej me ndonjë VKM për të përcaktuar një renditje, në varësi të zonave sizmike më të rrezikshme në Shqipëri.

Niko Peleshi – Besoj se atë e çmon vetë ministria në VKM.

(Diskutime pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti Marto!

Andrea Marto – Te fjalja e dytë e nenit 4/1, themi: “rregullat për mënyrën se si do të zbatohet auditimi dhe cilat do të jenë subjektet do të përcaktohet me VKM”. Për afatin kohor përsëri nuk themi gjë.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Për sa i përket kufizimit të auditimit teknik, si do ta vendosim?

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, do t’ju kërkoja që të qëndronit pak me shërbimin e komisionit për të bërë formulimin e auditimit teknik, i cili, pasi të votohet dhe pasi të pranohet, do të shtohet si pikë e dytë pas pikës së parë të nenit 2 të këtij projektligji. Unë nuk di ta formuloj tani, por, pak a shumë, është ajo që ju përmendët.

Ju lutem, bëni një formulim të shpejtë dhe më pas e saktësojmë këtu!

Agron Hysenlliu – “Auditimi teknik është aktekspertiza e thelluar, është dokumenti teknik që vlerëson shkallën e vjetërsisë së një objekti, gjendjen e një objekti dhe kapacitetet e tij mbajtëse”.

Niko Peleshi – Në rregull, gjithsesi saktësojeni më pas, por sa për votim ne kjo na duhet.

Atëherë, e hedhim në votim nenin 2 me dy paragrafë dhe me këtë shtesë?

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2 bashkë me shtesën e përkufizimit të auditimit, siç e lexoi edhe drejtori.

Kalojmë në nenin 3.

Për nenin 3 diskutuam gjatë dhe neni 3 i referohet nenit 6 të projektligjit dhe sjell zgjerimin e bazës së objekteve të detyrueshme për oponencë teknike, ku futen ndërtimet publike dhe objektet me akses publik, duke hequr tavanin e vlerës. Pra, të gjitha, pa përjashtim, ndërtimet publike dhe objektet me akses publik duhet të auditohen nga institucionet apo entet që do të përcaktohen nga ministria përkatëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, se u shpreha gabim “oponencë”.

E hedhim në votim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 3, ashtu siç është formuluar në variantin e Këshillit të Ministrave? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3 sipas variantit të Këshillit të Ministrave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Kam propozime për të dyja vendimet. Neni 3/1, apo si do ta quajmë?

Niko Peleshi – Neni 4.

Ilir Beqaj – Në rregull.

Neni 4, në nenin 10 shtohet ky paragraf: “Për çdo ndërtim me vlerë së paku 100 milionë lekë, zhvilluesi kryen dhe mban në fuqi gjatë gjithë periudhës së ndërtimit, sigurimin e detyrueshëm për të gjitha rreziqet për punimet e ndërtimit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Për të bërë këtë duhet të pyesësh një herë shoqëritë e sigurimeve se çfarë sigurojnë ato? Sepse mos kujto se ato sigurojnë çdo gjë. Kështu si thua ti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Varet sa paguan, sepse pastaj i bie se për çdo gozhdë që futet në...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Problemi është në 3 gjëra:

Ua futëm shoqërive të ndërtimit të gjitha, kjo duhet të futet dhe duhet të hiqet 10-vjeçari për banesë, sepse ai që blen një ndërtesë 200 metra katrorë 100 milionë ose 200 milionë euro nuk paska lekë të sigurojë veten e tij dhe duhet ta sigurojë ndërtuesi kot së koti!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kantierin po, por jo të sigurojë shtëpinë që e merr ti 200 milionë euro. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ilir Beqaj – Për çdo ndërtim me vlerë së paku 100 milionë lekë zhvilluesi kryen dhe mban në fuqi gjatë gjithë periudhës së ndërtimit sigurim të detyrueshëm për dëmin material dhe përgjegjësitë ndaj palëve të treta, pra dëmin material dhe përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, gjatë gjithë periudhës së ndërtimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po flas për ndërtimin, nuk të përmenda kontratë porosie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po flas për dëm material gjatë ndërtimit dhe përgjegjësia ndaj palëve të treta. Ky është propozimi im.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju kërkuam dhe thatë që do të rimë këtu. Prandaj vazhdojmë, sepse kemi hyrë në procedurë votimi.

Niko Peleshi – A ka ndonjë diskutim tjetër? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Personalisht, mendoj se është një propozim që sjell një ndryshim goxha të fortë në sektor dhe minimalisht grupet e interesit duhen konsultuar, sepse ka faturë financiare dhe burokratike. Kështu që nuk besoj se mund ta bëjmë këtë shtesë me iniciativën tonë në një mbledhje komisioni, sepse kërkon studim. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë kështu e gjykoj. Ky është mendimi im.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Unë ju bëra një propozim, minimalisht, votojeni.

Niko Peleshi – Patjetër që do ta votojmë, sepse është propozim.

(Diskutime pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Zoti kryetar, edhe unë i bashkohem qëndrimit tuaj. Ndoshta, në kuadër të gjithë këtij rishikimi që po i bëjmë situatës së ndërtimit në Shqipëri, edhe sigurimi i kantierit është një element, për të cilin duhet të mbajmë një qëndrim të caktuar në të ardhmen, por, besoj se sot nuk mund ta kalojmë dhe ta votojmë pa bërë procedurën normale që duhet për një propozim të tillë të rëndësishëm, duke dëgjuar qoftë grupet e interesit, por qoftë edhe shoqëritë e sigurimeve për t'u përgatitur se çfarë mund të sigurojnë. Kantieri në vetvete nuk është thjesht një objekt, kantieri ka shumë gjëra, duhet të fillohet që nga vinçi, që nga hyrja e betonierës, që nga vendi ku do të montohet, sepse brenda kantierit mund të ndodhin shumë gjëra. Kështu që edhe vetë sigurimi i kantierit ka për të qenë një gamë shumë e gjerë sigurimesh, nuk mund ta bëjmë me një fjalë, do të kërkojë kohën e saj. Në qoftë se i bashkohemi si shqetësim, që është koha për të filluar për të menduar për këtë gjë, jam plotësisht dakord, por ndoshta nuk e kalojmë dot sot.

Niko Peleshi – Edhe unë kështu mendoj.

Zoti Shkreli, si mendoni?

Artan Shkreli – Unë e gjej me shumë vend propozimin e zotit Beqaj. Domethënë e mbështes si propozim. I vetmi problem që kam, është problemi që u ngrit nga anëtarët e komisionit, që, minimalisht, kërkon një konsultim me grupin e interesit, sepse ky prek një grup

shumë të gjerë dhe shumë të fuqishëm interesi. Domethënë, duhet një konsultim, sepse edhe ata mund të jenë pro, nuk dua të paragjykoj askënd, por me shoqatën e ndërtuesve, me shoqatën e sipërmarrësve apo me dhomat e tregtisë, nuk e di ku janë të organizuar.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Meqenëse ky propozim që bën zoti Beqaj, është kritik dhe i rëndësishëm për ligjin, a mendoni që të mos e miratojmë sot? Nuk e di sa kohë ju duhet juve, që të vini me një projekt, ku të jetë rikonsideruar ky element dhe më pas...

Artan Shkreli – Ne mund të marrim një vendim të ndërmjetëm, të pranojmë një herë propozimin e zotit Beqaj, duke hapur kapitullin thjesht: “Objektet në ndërtim duhet të sigurohen” dhe më pas t’ia lëmë një akti nënligjor se si rregullohet sigurimi i kantierëve, i cili është krejt i ndryshëm nga sigurimi i banesave, pasi ato dorëzohen dhe janë mbaruar. Kjo do të ishte një gjë që... Më pas atë do ta konsultojmë me grupet e interesit, zoti Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, e hapim kapitullin e sigurimit të objekteve, sepse është një gjë e domosdoshme që duhet ta bëjmë dikur, por nuk specifikojmë gjëra, të cilat do të shoqërohen më pas me një vendim të Këshillit të Ministrave.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se u ezaurua në momentin që bie dakord zëvendësministri me propozimin e kolegut pararendës. Mendoj të rrijë spacio dhe koha është tani. Pra, nuk ka kohë tjetër, sepse ne i duam ndërtuesit e fortë, por tani disa ndërtues kanë ikur në drejtim të paditur tani, apo jo?

Niko Peleshi- Zoti Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si do të formulohet?

Ilir Beqaj - Për mua është më e rëndësishme që ato që janë me fonde publike, të sigurohen, sepse, në qoftë se unë kam marrë një kantier për ta ndërtuar e më ndodh diçka brenda këtij kantieri dhe humbas të gjitha këto vlera monetare, atëherë i gjithë kusuri i shkon buxhetit, ndërsa për ato që janë me fonde private, ai detyrimisht do të shkojë ta sigurojë, sepse është punë e tij....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka të bëjë me të tretët, sepse ti ke kontratë porosie me mua dhe kontratën e porosisë ose ta bëj, ose jo dhe, nëse ta bëj kontratën, ti do të qëndrosh, nëse jo, të kthej paratë. Është çështje e kontratës kur ndodh dëmi, sepse në kontratë thuhet: “Forcat madhore ...”, ndërsa ne po flasim për sigurim kantieri, sepse sigurimi kantierit ka të bëjë me vlerat...

Niko Peleshi - Zoti Pëllumbi, fjala për ju.

Arben Pëllumbi - Mua më vjen mirë që po gjejmë gjuhën, sepse të gjithë bashkë jemi dakord që duhet ta mbështesim idenë e sigurimit të kantierit, por puna është se, në qoftë se e bëjmë edhe në formën që thatë ju, kemi implikime në buxhet, sepse ndonjëherë kantieret e punëve publike duhet të sigurohen dhe janë të paparashikuara në buxhetin e vitit 2020.

Ilir Beqaj- E fusim në këtë nen, në vitin 2021.

Arben Pëllumbi- Dakord.

Niko Peleshi- Prandaj duhet studiuar, është...

Ilir Beqaj –Sigurimi 0,3% e vlerës së investimit...

Niko Peleshi - Unë personalisht i qëndroj mendimit se nuk mund të bëjmë një ndryshim të tillë pa e studiuar dhe pa lënë institucionet të punojnë për të.

Agron Hysenlliu - Një nga kriteret është edhe vlera e sigurimit. Në përgjithësi ka një praktikë, ku vlera e sigurimit është vlera e vetë kontraktimit. Për shembull, një objekt që bën 100 milionë, supozojmë një rrugë gjigande, apo autostradë...

Niko Peleshi- Këto janë detaje.

Agron Hysenlliu – Dakord, por po them që ne nuk i futemi fare kësaj historie dhe po të donim mund të bënim vetëm një nen, ku kantieret, objektet në ndërtim duhen siguruar dhe pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbi 100 milionë, aty ku bëhen edhe oponencat dhe rregullat sipas VKM-së.

Niko Peleshi- Ne mund të fusim vetëm një nen, por ai nen do të mbajë peng të gjitha investimet në të gjithë Shqipërinë deri sa të dalë VKM-ja, aktet nënligjore e të tjerë.

Ilir Beqaj- Nuk është ashtu.

Niko Peleshi- Pse?

Ilir Beqaj- Sepse ligji i territorit doli në vitin 2014 dhe detyroi sigurimin e detyrueshëm, VKM-ja doli në muajin tetor të 2019-ës dhe për 5 vjet nuk u mbajt peng asgjë. Edhe ai ligj kishte 5 vjet që nuk zbatohet, sepse nuk kishte dalë VKM-ja dhe nuk mbajti peng asgjë, u lidhën kontrata pronësie.

Niko Peleshi- Unë nuk jam jurist, por, në qoftë se ka një përcaktim ligjor, nuk besoj se mund të shkelet, duke u justifikuar që...

Ilir Beqaj –As unë nuk e di, por po them faktin që ka ndodhur.

Niko Peleshi –Fakti është diçka tjetër. Në qoftë se është vepruar në kushte ekstraligjore, nuk do të thotë se nuk përbën argument. Në qoftë se nuk ka dalë VKM-ja, nuk mund të justifikohet moszbatimi i ligjit.

Ilir Beqaj – Po në funksion të kësaj, unë ju propozoj dy nene. Neni i parafundit, edhe pa këtë shtesë, duhet të ishte që për nenin 2 duhet të caktojmë afat kur të dalë VKM-ja, sepse edhe për këto 50- vjeçaret VKM-ja mund të mos dalë për 5 vjet dhe nuk fillon. Unë e mbështes propozimin e zëvendësministrit me VKM, dhe mund të them që VKM-ja del brenda 12 muajsh. Kjo do të thotë që për 12 muaj kjo pikë e ligjit nuk ka hyrë ende në fuqi, sepse nuk ka dalë VKM-ja.

Ardit Konomi - I lëmë një afat 12 muaj, që i jep mundësi edhe për ta diskutuar, studiuar dhe thelluar me grupet e interesit për të bërë një gjë të pjekur, por nuk bëjmë dot nëse nuk e hapim rrugën në ligj.

Niko Peleshi - Dakord, por si shkon sigurimi i kantierit me qëllimin e këtij projektligji? Ne nuk mund të dalim nga qëllimi bazë i projektligjit, por mund të bëjmë ndryshime që ngelen brenda atij qëllimi dhe brenda asaj fryme. Ilir, sigurimi është një koncept komplet i ri.

Ilir Beqaj – Me projektligjin nuk shkon, por me ligjin që amendojmë sot, shkon, sepse ligji quhet “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. Pra, gjatë gjithë kohës, nga marrja e lejes së ndërtimit deri te kjo që quajtmë sot certifikatë përdorimi, ky është cikli i ndërtimit, që ligji i 1998-ës e rregullon.

Niko Peleshi- Dakord, por ne nuk po shqyrtojmë në themel ligjin bazë dhe nuk po bëjmë një ligj të ri, por po bëjmë një amendament të projektligjit me një qëllim të caktuar dhe nga ky qëllim nuk dalim dot.

Ilir Beqaj- Atëherë, po dorëzoj javës tjetër të njëjtën gjë.

Niko Peleshi- Dakord, jemi korrektë me procedurat ligjore dhe parlamentare.

Ilir Beqaj –Derisa erdhi radha, pasi mbaroi neni 6 i origjinalit, thashë që kam një propozim te neni 10.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Demokraci është kjo, vendos shumica.

Niko Peleshi- Unë e shpreha mendimin tim.

Në qoftë se nuk ka diskutime të tjera, kalojmë në votimin e propozimit të zotit Beqaj.

Ilir Beqaj – Ta lexoj përsëri propozimin?

Niko Pelshi- Po.

Ilir Beqaj - “Për të gjitha ndërtimet me vlerë mbi 100 milionë lekë zhvilluesi kryen dhe mban në fuqi gjatë të gjithë periudhës së ndërtimit sigurimin e detyrueshëm nga rreziqet për punimet e ndërtimit, rreziqe, të cilat sigurohen dhe rregullat e sigurimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Ka disa afate që duhet të zgjedhim dhe neni i afateve, zakonisht në teknikë, është neni i parafundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Derisa thashë që mban sigurimin e detyrueshëm, është e njëjta gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kontratën, sepse e lidhë sot, por ai mund ta lidhë për 6 muaj dhe vjen me një kontratë 6-mujore, ndërkohë që kantierin e ka tre vjet. Prandaj duhet që gjatë gjithë periudhës...

Zoti Zëvendësministër, ju e dini më mirë, ai ka marr një leje për tre vjet, e shtyn edhe një vit për arsye të veta dhe do të shkojë të shtyjë edhe atë.

Niko Peleshi- Është e qartë. Ndryshimet sintaksore i rregullojmë pastaj, shikoni përmbajtjen.

Ilir Beqaj – Kështu e ka quajtur ligji. Elementet e sigurimit të detyrueshëm dhe rregullat e sigurimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, ato që thamë, pala e tretë, dëmi, gozhda, makina e të tjerë, nuk po hyjmë këtu, VKM-ja i shkon në detaje.

Ardit Konomi- Lidhur me nenin 3, vazhdoj të kem një problem me përcaktimin për ndërtime së paku 100 milionë lekë, ose mbi 100 milionë lekë. Nuk është fare e përcaktuar. Çfarë ndodh me një ndërtim që kushton 95 milionë lekë? Ku është dallimi? Këtu flitet për kategori dhe çmimi nuk përcakton gjë.

Ilir Beqaj – Koleg, 100-ën e mora për referencë, meqenëse e kemi përdorur këtu, por nuk jam dakord që të ulemi pa një prag, sepse në kontratat e sigurimit ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka te 100 milionëshi. Të njëjtën gjë thotë: “Pse nuk e bën 90, por 100”. Unë mendoj se një ndarëse duhet të ketë. Pse?! Sepse kontratat e sigurimit kanë edhe një kosto fikse administrative, e cila është regressive. Në qoftë se vlera që sigurohet është e vogël, kjo kosto është e ndjeshme dhe e bën primin të rëndë, ndërsa në pjesën administrative në një kontratë mbi 1 milion dollarë, e bën më pak sinjifikative pjesën administrative.

Së dyti, një investitor mbi 100 milionë i ka kapacitetet edhe të negociojë me kompaninë e sigurimit, ndërsa një investitor 10 milionë, që mund të jetë një familjar, nuk ka kapacitete dhe vendoset në një pozicion pak të pafavorshëm dhe kapaciteti financiar, mendoj unë, e vendos në një raport më të barabartë. Pse zgjodha 100 dhe jo 90, ishte thjesht sepse ishte një shifër e referuar dhe për oponencën teknike. Kjo shifër ka nga viti 1998 që është në fuqi, madje atëherë ka qenë një vlerë në lekë, që nuk ka ndryshuar për 22 vjet edhe pse inflacioni e ka bërë të tillë që të jetë për vepra më të lira se ç’ka qenë në vitin 1998, apo shtrenjtimi i ndërtimit.

Niko Peleshi- Eglantina Gjermani.

Eglantina Gjermeni- Thjesht për të qenë demokratike deri në fund, mendova që të ftonim grupe interesi, por, në qoftë se ju jeni dakord dhe pastaj të përcaktohet me VKM, jam dakord të kalojmë në votim.

Niko Peleshi- Ose jo, sepse unë jam kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zef, është nen i veçantë.

Kalojmë në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është nen i veçantë. Pra, po hedhim në votim propozimin e zotit Beqaj për të shtuar një nen, që do të jetë neni...

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Dakord pra, do të shtojmë një nen në këtë projektligj, që do të jetë neni 4, i cili ndryshon një paragraf të nenit 10 të ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Formulimin nuk po e përsëris, pasi e dëgjuam nga zoti Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, që të mos bëjmë gabime njerëzore të paqëllimshme.

Kush është dakord? Ju lutem, numërojeni pak votat!

Elona, i numërove? Unë jam kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani jemi te pro-ja. 8 vota pro.

Kush është kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ardit, jeni pro, apo kundër? Jeni kundër.

Ilir, je pro, apo kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edi? Jeni pro. Atëherë, janë 5 vota kundër.

Ilir Beqaj – Ku janë pesë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Me Arditin bëhen tre, me Bertin bëhen katër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe ti, Tina?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, katër vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet propozimi i zotit Beqaj.

Para se të vijojmë me nenet e tjera, që më duket se do t'i propozojë zoti Beqaj, kam një pyetje, e cila mund të kthehet në nen në varësi të përgjigjes suaj: kush e mban përgjegjësinë ligjore, në rast se personi apo institucioni që ka kryer oponencën, ka gabuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush e ka përgjegjësinë ligjore? Në rastin e zbatimit, e dimë që e kanë supervizori, kolaudatori. Për projektin unë nuk di të kemi ndonjë institucion të përcaktuar se ku shkon përgjegjësia ligjore në rastet e gabimeve në projekt.

Agron Hysenlliu – Të përgjigjem?

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Agron Hysenlliu – Atëherë, ne duhet të konceptojmë që përgjegjësinë ligjore në një projekt të caktuar e ka kompania që kryen projektin, që ka brenda saj arkitektë, hidrologë, konstruktorë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ju lutem, ta dëgjojmë drejtorin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gjuzi, ju lutem!

Urdhëroni! Kush e mban përgjegjësinë ligjore?

Agron Hysenlliu – Të shprehem?

Niko Peleshi – Një objekt ka një oponencë të firmosur, bie fjala, nga Niko Peleshi, por objekti rrëzohet. Kush e mban përgjegjësinë e gabimit në projektim?

Agron Hysenlliu – Gabimin në projektim e mban konstruktori. Oponenca teknike në vetvete...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ta mbaroj fjalën!

Oponenca teknike në vetvete është rekomandim për kushtet teknike. Oponenca teknike kontrollon dhe i thotë që, kur janë zbatuar kushtet teknike dhe e rikthen në origjinë, atje tek investitori, ky nuk ka zbatuar një, dy, tre, katër, shtatë. Vendimmarrja u takon KKT-ve, KRRT-ve ose atyre që kanë vendimmarrje mbi projektin.

Duke marrë oponencën teknike, ata kanë të drejtë që ta rikthejnë oponencën teknike për të riparë se si është projektuar objekti ose për ta kaluar në atë gjendje që është objekti.

Niko Peleshi – E kam fjalën për skenarin kur oponenca teknike certifikon një projekt, i cili, në fakt, ka gafa teknike.

Agron Hysenlliu – Në qoftë se oponenca teknike certifikon që ka gafa teknike, përgjegjësinë e mban...

Niko Peleshi – Jo them kur oponenca e ka certifikuar, pra ka thënë se ky projekt është okej, por, në fakt, ai nuk është okej.

Agron Hysenlliu – Oponenca teknike nuk bën llogaritje, sepse nuk është recencë, por bën vetëm kontrollin e kushteve teknike mbi projektin. Në qoftë se kushtet teknike të projektit janë zbatuar në rregull, se pastaj del jashtë loje projektuesi...

Niko Peleshi – Po në qoftë se nuk janë zbatuar dhe oponenca thotë se janë zbatuar?

Agron Hysenlliu – E rikthen dhe i thotë: “Nuk ka plotësuar kushtet”.

Niko Peleshi – Po në qoftë se nuk janë zbatuar, por oponenca...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Hysenlliu – Mban përgjegjësi.

Niko Peleshi – Pikërisht, këtë përgjegjësi si e mban? Ku përcaktohet përgjegjësia?

Agron Hysenlliu – E mban me ligj. Këtë e përcakton prokuroria mbi bazën e...

Niko Peleshi – Por prokuroria i referohet një ligji.

Agron Hysenlliu – Po pra.

Niko Peleshi – Ku thuhet që përgjegjësinë e mban oponenca dhe çfarë lloj sanksionesh apo çfarë lloj përgjegjësish ka mbi atë që ka bërë oponencën false?

Agron Hysenlliu – Përgjegjësitë fillojnë që nga heqja e licencës deri te përgjegjësia penale.

Niko Peleshi – Ku përcaktohen këto?

Agron Hysenlliu – I keni te ligji për dhënien e licencave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ju lutem, se këto deklarime janë me përgjegjësi!

A specifikohet te ligji i licencave që, në qoftë se oponenca teknike është bërë në mënyrë fiktive, i hiqet licenca inxhinierit, ekspertit që ka firmosur oponencën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Shkreli – Kjo është njësoj sikur ambulanca të më japë një shënim që jam i aftë të marr patentën pa më bërë asnjë lloj kontrolli. Në qoftë se unë kryej një aksident, pasi nuk shoh mirë, kush e mban përgjegjësinë?! Këto janë histori për të cilat secili nga profesionet është i rregulluar vetë: profesioni i arkitektit, i inxhinierit... Çdo njeri që firmos mbi bazën e kompetencës së tij profesionale, mban përgjegjësi, në qoftë se firma është hedhur në mënyrë fiktive. Nuk është që oponenca duhet ta ketë ndryshe nga një inxhinier, por janë identike.

Niko Peleshi – Por përgjegjësitë janë të shprehura në ligje.

Artan Shkreli – Sigurisht që po.

Niko Peleshi – Për konstruktorin janë të shprehura, për zbatuesin janë të shprehura...

Artan Shkreli – Çdo njeri që firmos...

Niko Peleshi – ...edhe për supervizorin, edhe për kolaudatorin është e shprehur heqja e licencës, ndjekja penale e të tjera. Po për entin apo për personin që kryen oponencën?

Artan Shkreli – Ky person është inxhinier ose arkitekt, është njësoj si supervizori.

Niko Peleshi – A janë të specifikuara diku përgjegjësitë ligjore?

Artan Shkreli – Absolutisht po.

Niko Peleshi – Ku?

Artan Shkreli – Edhe te rregullorja e licencave janë të specifikuara, se kur të hiqet licenca, sa muaj të hiqet, kur të hiqet përgjithmonë, madje edhe se kur shkon për ndjekje penale; janë të përcaktuara me shkallë.

Niko Peleshi – Do ta verifikojmë.

Artan Shkreli – Janë, patjetër.

(Mungesë regjistrimi)

Niko Peleshi – Shëndet! Gjithë të mirat!

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Për mua të gjitha këto histori kanë një çelës, komplet te profesionistët; sigurimi profesional. Dëmi...

Jo, ta them sinqerisht, ai i rregullon të gjitha! E kalon në civile, nuk është as prokuroria, as të them e të thashë. Fut sigurimin profesional, ai që firmos, shkon te kompania, siguron profesionin dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Sigurimi nuk bëhet te noteri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo kompani sigurimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, në qoftë se përgjegjësia për supervizorin dhe për kolaudatorin është e specifikuar në ligj, unë mendoj që duhet të specifikohet edhe për oponentin teknik.

Artan Shkreli – Njësoj është, sepse një lloj kolaudimi është edhe ky në njëfarë mënyre, ose një lloj supervizioni. Pra, është absolutisht e njëjta figurë profesionale që bën edhe këtë dhe mban fiks të njëjtën përgjegjësi.

Unë po them vetëm një gjë.

Niko Peleshi – Për këtë arsye unë mendoj që duhet të kemi të njëjtin standard. Kaq është diskutimi im.

Artan Shkreli – Jo, jo, e kuptoj edhe shqetësimin tuaj! Keni shumë të drejtë, sepse, në fund të fundit, çfarë të them unë, një njeri futet te një banesë dhe thotë: këtë e kam të sigurt, sepse ma ka dhënë Instituti i Ndërtimit. Po e zuri brenda atë, kush e mban përgjegjësinë?! E ke tek Instituti i Ndërtimit. E mban i gjithë Instituti, e mban kush ka firmosur (inxhinieri)...

Unë them që shkohet sipas përgjegjësive individuale të firmave, të atyre që kanë vënë firmat, pavarësisht se çfarë akti bën ai: kolaudim, supervizion, auditim e të tjera. Pra, ai i nënshtrohet së njëjtës masë penalizimi sikurse të ketë bërë edhe një gjë tjetër.

Unë di të them vetëm diçka dhe po bëj një pauzë të vogël për kuriozitet: në Shtetet e Bashkuara të Amerikës mjafton të kesh titullin “Inxhinier” dhe, në qoftë se ke mbaruar për inxhinieri ndërtimi, mund të firmosësh edhe për anije kozmike. Por asnjë inxhinier ndërtimi nuk firmos për një anije kozmike ose për një inxhinieri kimike, pavarësisht se atij i thuhet “inxhinier”. E ka inxhinier dhe mund ta bëjë. Janë aq të fokusuar te firma dhe te fusha e tyre, saqë nuk firmosin kurrë për një gjë për të cilën nuk kanë autoritetin, sepse ligji i djeg ata menjëherë. Ndërsa shqiptarët firmosin tek objekti i tyre edhe fare pa objektin. Çfarë të të them unë ty?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po pra, sepse duhet të jetë disi e balancuar.

Në rast se ne i dërgojmë Institutit (kur them Institutit, nuk kam parasysh Gonin, pasi ai nuk do të jetë gjithë jetën, si gjithsecili prej nesh) gjithë këtë volum pune, në qoftë se ky volum pune nuk shoqërohet me përgjegjësi, atëherë, më falni që po shkoj në ekstrem, kthehet në biznes të paligjshëm për ata, pa firmën e të cilëve ti nuk vazhdon dot më tej. Ne e dimë se çfarë do të thotë një firmë.

Tani, në mënyrë që kjo të mos kthehet në korrupsion, duhet që të ketë përgjegjësi. Ti mund të firmosësh, ke një volum shumë të madh pune, por do të mbash përgjegjësi për çdo firmë që hedh. Këtë kisha parasysh. Pra, të mos jetë një veprimtari që kryhet pa asnjëlloj përgjegjësie dhe na kthehet pastaj në një fiktivitet.

Artan Shkreli – Absolutisht.

Niko Peleshi – I bëjnë oponencat vetë, i çojnë atje, i firmosin dhe marrin lekët ata që janë pas sportelit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, Goni! E kam vetëm ...

Agron Hysenlliu - Edhe për sa u përket ndërhyrjeve për aktet e ekspertizave të tërmetit, Instituti i Ndërtimit në këtë rast ka shërbyer si një lloj dispeçerie. Është një dispeçeri, e cila kontrollon forcat inxhinierike të vendit duke u mbështetur kryesisht në entet publike, që mund të mos jenë shtetërore: universitete, bashki, institute të ndryshme, licenca private e të tjera, dhe del garant që këta janë njerëz të certifikuar nëpërmjet licencave të tyre dhe që mund ta bëjnë këtë punë. Pastaj, ata mund të çmenden dhe i firmosin nga shtëpia, pa shkuar t'i shikojnë fare, sepse duan të bëjnë biznes. Kjo është një çështje komplet tjetër që nuk e kontrollojmë dot.

Niko Peleshi – Dakord. Ju thoni që përgjegjësitë janë të rregulluara në ligje të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, nuk kemi debat!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Hysenlliu – Vetëm një sekondë.

Niko Peleshi - U bëre parlamentar tani. Vazhdo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Beqaj ka propozim për një nen 5.

Ilir Beqaj – Atëherë, në bashkëpunim edhe me ministrinë, për auditin teknik, sa kohë mendoni se ju duhet për ta bërë gati projektin për në Këshillin e Ministrave, që të mos vendosim një afat arbitrar, 3, 4 apo 6 muaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju bëjeni për sa të doni ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tre muaj, por ju bëjeni më shpejt.

Për çështjen e sigurimit, meqenëse është çështje e diskutueshme, t'i lëmë 9 muaj kohë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të kemi parasysh që ky do të hyj në fuqi në mars. Do të miratohet në seancë, do dekretohet 15 ditë pas botimit dhe në mars ... Pas 9 muajve mbyllet viti. Nëse e zgjasim, e çojmë për në muajin prill të vitit 2021. Prandaj e propozova për 9 muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozim: Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të nenit 2, të nxjerrë VKM-në brenda tre muajve dhe në zbatim të nenit 4 të nxjerrë VKM-në brenda 10 muajve.

Niko Peleshi – Ka diskutime?

Hedhim në votim nenin 5 sipas formulimit të zotit Beqaj. Pro? Kundër? 1 kundër.
Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 6. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar””.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit të gjithëve!

Faleminderit edhe përfaqësuesve të ministrisë! Ju lodhëm pak, por është një ligj i rëndësishëm. Drejtor, punë të mbarë dhe me shpatulla të forta!

Faleminderit!